



## OPINION TOLLOVIA

NGA EDISON YPI  
► FAQE 14

### TIRANE

# Kryebashkiaku Veliaj: Nuk do të ketë ndërtime në Kopshtin Botanik

► FAQE 7

### REFORMA ZGJEDHORE

# 14 NDRYSHIMET E PARA NE KODIN ZGJEDHOR, SI ISHIN DHE SI BEHEN

Kush financon partitë nuk merr para publike për tre vjet, vendoset kufi për shpenzimet, ndalohen afishimi i materialeve propagandistike në vende publike

ADRIATIK DOÇI

► FAQE 2

### OPOZITA

# PD-LSI tryezë paralele për reformën zgjedhore, ja grupet e punës



Sot mbledhja e komisionit për reformën zgjedhore. PD nuk tërhiqet nga kushtet. Drafti për financimin e partive, Hajdari-Gjoni për Report Tv: S'ka kontestime për këtë pikë

► FAQE 3

# SHQIPTARJA.com

ÇMIMI 30 LEK

VITI IX - NR. 253(2775)

E ENJTE, 24-10-2019

www.shqiptarja.com

### EKSKLUZIVE

# Basha shpenzoi 9% të buxhetit të PD kundër ambasadores së SHBA

Ja ku i mori paratë kreu i PD për të lobuar kundër Kathleen Ann Kavalec, e propozuar për ambasadore në Tiranë

► FAQE 4

NGA ADRIATIK DOÇI

### NGERÇI BUROKRATIK

# Si makina me 0 km dalin të vjedhura, Nasufi: 15 raste këtë vit

Pavarësisht se qytetarët i blejnë tek koncesionarët, përgjegjësi i regjistrimit të automjeteve sqaron se nuk ka dëmshpërblim kur mjeti sekuestrohet

► FAQE 11

NGA ELIZA GJEDIKU

### PUSHTETI VENDOR

# Bashkitë 50 mln euro borxhe, qeveria bën gati administratorët

Afat deri në fund të vitit për të rregulluar bilancet e tyre financiare

► FAQE 6

NGA GENC KONDI

### MISTERET E DIKTATURES

# Zbulohet qelia e torturave të hetuesve komunistë ku vdiqën 50 korçarë

Dëshmia rrëqethëse e Ylber Mejdanit: Në bodrumet e ish Komitetit të Partisë, 4 qeli 1 metër katror, ku torturoheshin kundërshtarët e rregjimit, nga 1945 në '54-n

► FAQE 16

NGA GLADIOLA HOXHA

### 148-VJETORI I LINDJES

# GJERGJ FISHTA, RILINDJA SHQIPTARE DHE POEMA "LAHUTA E MALCÍS"

► FAQE 12-13

NGA BLERINA SUTA



## SKANDALI

# SI GJIN GJONI DHE ARJANA FULLANI LIRUAN BOSIN E DROGES QE KERKOHET SI TERRORIST

18 muaj pas parandalimit të një sulmi gjatë kremtimit të festës së sulltan Nevruzit në Tiranë parandalohet sulmi ndaj muxhahedinëve të strehuar në Shqipëri, policia zbulon celulën terroriste iraniane. Në krye Abdulsalam Turgut, i cili u lirua nga burgu i Tiranës me dy vendime të dyshimta



► FAQE 8-9

# 14 ndryshimet e para në Kodin Zgjedhor, si ishin dhe si bëhen

Kush financon partitë nuk merr para publike për tre vjet, vendoset kufi për shpenzimet, ndalohen afishimi i materialeve propagandistike në vende publike

ADRIATIK DOÇI  
TIRANE

Report TV dhe Shqiptarja.com zbardhi draftin e punës për ndryshimet në Kodin Zgjedhor për çështjet e financimit të partive dhe barazinë gjinore. Komisioni i Reformës Zgjedhore është i ndarë në tre grupe pune dhe njëri prej tyre po diskuton pikërisht çështjen e financimit të partive politike. Një nga ndryshimet kryesore është pika ku u ndalohet donatorëve të partive politike në fushatat zgjedhore që të përfitojnë kontrata publike apo si nënkontraktorë për 3 vite ose në çdo mënyrë tjetër për fonde që tejkalojnë 10 mln lekë. Në draft ndalohen donacionet mbi 30 mijë lekë cash, kur nuk është bërë përmes transaksioneve bankare dhe dënohet me një gjobë



të barabartë. Gjithashtu është vendosur një kufi, ku shuma që shpenzojnë partitë politike në një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 2 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore. Ndryshimet rrisin gjithashtu prezencën e femrave në Kuvend dhe qeverisjes vendore, ndërsa bëhet e detyrueshme përfshira e femrave në masën mbi 30 për qind në të gjitha komisionet e administrimit të zgjedhjeve. Po ashtu është vendosur ndalimi i përdorimit të burimeve njerëzore, përfshirë edhe presionin ose ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore edhe jashtë orarit të punës ose mësimin. Gjithashtu ndalohet për herë të parë afishimi i materialeve propagandistike në vende publike.

## Ndryshimet

Një nga ndryshimet kryesore është pika ku u ndalohet donatorëve të partive politike në fushatat zgjedhore që të përfitojnë kontrata publike apo si nënkontraktorë për 3 vite ose në çdo mënyrë tjetër për fonde që tejkalojnë 10 mln lekë.



## Drafti i parë

Komisioni i Reformës Zgjedhore është i ndarë në tre grupe pune dhe njëri prej tyre po diskuton pikërisht çështjen e financimit të partive politike. Njëri grup ka paraqitur draftin e parë.



## 14 NDRYSHIMET E PLOTA NË KODIN ZGJEDHOR

### 1. KUOTAT GJINORE (DETYRIMI I PËRFAQËSIMIT TË FEMRAVE EDHE NË KOMISIONET ZGJEDHORE)

**ISHTE:** Për çdo zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind e listës shumëmbrore dhe një në tre emrat e parë të listës shumëmbrore duhet t'i përkasë secilës gjini. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, për çdo këshill bashkie, një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini.

**BËHET:** Kuotat gjinore në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së Kuvendit të Shqipërisë dhe 50 për qind të organeve të njësive bazë të qeverisjes vendore. Vendosjes së kuotave gjinore në jo më pak se 30 për qind të përbërjes së të gjithë niveleve të administratës zgjedhore. Për çdo zonë zgjedhore jo më pak se një në çdo tri emra të njëpasnjëshëm në renditje të listës shumëmbrore duhet t'i përkasë secilës gjini. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore për çdo këshill bashkiak një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë secilës gjini.

### 2. VEPRIMTARIA E INSTITUCIONEVE NË FUSHATË (FORCOHEN RREGULLAT)

**ISHTE:** Aparati i Këshillit të Ministrave dhe i Kryeministrisë, çdo ministri, zyra e prefektit dhe bashkitë janë të detyruara të caktojnë nëpunës ndërlidhës, përgjegjës për shkëmbimin e informacionit me KQZ-në, për veprimtaritë që kanë lidhje me administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike. Në rast se KQZ-ja vlerëson se veprimtaria e institucionit mund të dëmtojë ose të pengojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente, atëherë KQZ-ja informon me shkrim nëpunësin ndërlidhës të institucionit përkatës jo më vonë se 5 ditë përpara datës së përcaktuar për fillimin e veprimtarisë.

**BËHET:** Institucionet publike, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të raportojnë në

KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit, ose sipas rasti, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv). Raportimi duhet të kryhet jo më vonë se 48 orë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Për qëllimin e raportimit KQZ-ja mban dhe administron ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike. Personat përgjegjës marrin akses të personalizuar tek kjo ndërfaqe dhe hedhin të dhënat për datën dhe orën e veprimtarisë, llojin e saj, tematikën, nivelin më të lartë të pjesëmarrjes, të ftuarit e nderit, folësit e planifikuar dhe mediatizimin. Informacioni sipas këtij paragrafi është i aksesueshëm nga të gjithë përdoruesit e ndërfaqes nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni sipas pikës 2 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj. Veprimtaritë e ndaluar nga KQZ-ja nuk lejohet të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione.

### 3. PËRDORIMI I ADMINISTRATËS NË ZGJEDHJE (DY NDALIME TË REJA)

**SHTOHEN:** Ndalohet Përdorimi i burimeve njerëzore përfshin edhe presionin ose ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimin. Ndalohet transmetimi nga Radio Televizioni Publik i aktiviteteve të

institucioneve publike qendrore dhe vendore për qëllime zgjedhore.

### 4. NDRYSHIMET NË ZGJEDHJE (SHTOHET BETIMI I KRYETARËVE TË PARTIVE)

**SHTOHET:** Deklaratë me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet. Teksti i deklaratës përcaktohet me vendim të KQZ-së."

### 5. PARASHIKIMET NË KODIN PENAL REFLEKTOHEN NË KOD PËR VEPRIMET E PALIGJSHME NË ZGJEDHJE

**SHTOHET:** Subjekteve zgjedhore u ndalohet dhe mbajnë përgjegjësi penale në rast se ofrojnë ose japin të holla, të mira materiale, premtojnë për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për t'u angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike.

### 6. MATERIALET PROPAGANDISTIKE (NDALOHEM NË VENDET PUBLIKE)

**ISHTE:** Kryetari i njësive të qeverisjes vendore cakton, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike.

**BËHET:** Ndalohet përdorimi i materialeve propaganduese statike në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të këtij neni. Me "materiale propaganduese statike" kuptohen të gjitha materialet që i shërbejnë subjektit

zgjedhor apo partisë politike për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira publike me akses publik, si shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët ballore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse, etj.

### 7. MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

(Thjeshtohet monitorimi dhe hiqet bordi i monitorimit të media, duke shfuqizuar nenin 81/1)


### 8. FINANCIMI I ZGJEDHJEVE (NDRYSHON FORMULA, PËRFITONJË 10% TË FONDIT KANDIDATËT E PAVARUR)

**ISHTE:** 95 për qind e fondit i shpërndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, të cilat kanë përfituar jo më pak se 0,5 për qind të votave të vlefshme në zgjedhjet paraardhëse; 5 për qind e fondit i shpërndahet partive politike që janë regjistruar si subjekte zgjedhore dhe që nuk përfitojnë sipas shkronjës "a" të këtij neni.

**BËHET:** 90 për qind e fondit i shpërndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore të cilat kanë marrë jo më pak se 0,5 për qind të votave të vlefshme në zgjedhjet paraardhëse. Dy të tretat e këtij fondi ju jepet këtyre partive si paradhënie, ndërsa një e treta e tij u shpërndahet pas zhvillimit të zgjedhjeve dhe dorëzimit të raporteve financiare respektive në KQZ. 10 për qind e fondit i shpërndahet partive politike dhe kandidatëve të pavarur të regjistruar si subjekte zgjedhore dhe që nuk përfitojnë sipas shkronjës "a" të këtij neni.

### 9. FINANCIMI I PARTIVE (FORCOHEN RREGULLAT DHE KUSHTET)

**ISHTE:** Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij, nëse ndodhet ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 2 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;



# PD-LSI tryezë paralele për reformën zgjedhore, ja grupet e punës

*Sot mbledhja e komisionit për reformën zgjedhore. PD nuk tërhiqet nga kushtet. Drafti për financimin e partive, Hajdari-Gjoni për Report Tv: S'ka kontestime për këtë pikë*

**P**D dhe LSI nuk do të marrin pjesë në mbledhjen e sotme të komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, por do të punojnë të veçuara nga mazhoranca dhe opozita parlamentare. Në të njëjtën orë që do të zhvillohet takimi i radhës të Kryesiasë dhe Kuvendit për të ngritur grupet e punës që do të punojnë për sistemin zgjedhor dhe votën e emigrantëve, opozita do të zhvillojë një "tryezë paralele" në selinë blu, pikërisht për Reformën Zgjedhore. "Opozita është thëllësisht e angazhuar me Reformën Zgjedhore. Ne kemi bërë të qartë tek Tryeza e organizuar nga OSBE që duam të japim kontributin tonë për Reformën. Për këtë qëllim, nesër në orën 9.30, do të mbledhet grupi i punës së opozitës së bashkuar për reformën zgjedhore", tha një burim nga PD-ja. Potë njëjtat burime bëjnë me dije

se grupi i punës do të drejtohet në nivel politik nga Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Gazment Bardhi. Nga PD-ja do të jetë pjesë e grupit të punës Oerd Bylykbashi, Ivi Kaso, Enkelejd Alibeaj, Çlirim Gjata, Endri Hasa dhe Arben Ristani. Të gjitha partitë e koalicionit do të kenë përfaqësuesit e tyre në grup pune: LSI ka caktuar 3 përfaqësues, Ilirjan Muho, Muharrem Çakaj dhe Silva Çakaj, PR dhe PDIU nga 2 përfaqësues, PAA, PDK, LXHK, PBDNJ nga një përfaqësues.

## OPOZITA ERE

Kryetarja e grupit Demokrat në Kuvendin e Shqipërisë, Rudina Hajdari në një intervistë për gazetaren e Report Tv, Klesiana Omeri u shpreh se ky draft, pra i financimit të partive politike nuk ka kontestime nga opozita e re. "Në takimin e fundit komisioni për

**Bojkoti Partia Demokratike nuk do të marrë pjesë as sot në mbledhjen e komisionit të reformës zgjedhore. PD-ja thotë se është gati për të qenë pjesë e tryezës, por me kushte.**

reformën zgjedhore ra dakord që të merremi me pikat që janë më pak problematike, që janë jo të kontestueshme për opozitën dhe PS-në. Ky draft është një draft i pjesshëm nuk merret me çështje thelbësore, por me disa pika që nuk janë të kontestueshme nga palët. Prandaj dhe është bërë propozimi, që propozimi i parë që do të vijë në komision për sa i përket rekomandimeve të OSBE do të merret me pikat më pak të kontestueshme", tha Hajdari. Hajdari vijoi që të këmbëngulë që nuk do të heqë dorë nga kushti që reforma zgjedhore të miratohet në një fazë dhe jo dy, sikur kërkon shumica socialiste dhe që të përfshijë edhe ndryshimin e sistemit, teksa propozimet opozita e re do i publikojë në nëntor. Edhe deputeti Ralf Gjoni në një intervistë për Report Tv tha se opozita është e vendosur për ndryshimin e sistemit zgjedhor.

**BËHET:** Ndalohet dhënia e fondeve nga një person juridik apo çdo aksionar i tij, nëse ndodhet ka përfituar fonde publike, kontrata publike apo koncesione në 3 vitet e fundit me vlerë mbi 10 milionë lekë;

**SHTOHET:** Personat fizikë ose personat juridikë që i kanë bërë dhurime një partie politike apo kandidatit në zgjedhje nuk mund të përfitojnë për periudhën deri 3 vjet pas datës së zgjedhjeve, kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën prej 10 milion lekë, përfshirë edhe si nënkontraktues të një kontrate/koncesioni publik.

**ISHTE:** Shpenzimi total që mund të kryejë një parti politike, përfshirë edhe kandidatët e tyre, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojë 10-fishin e shumës më të madhe që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike.

**BËHET:** Shuma e shpenzimeve të bëra nga një parti politike, përfshirë kandidatët e saj, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 2 herë më e madhe se shumën e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore.

## 10. DEKLARIMI I SHPENZIMEVE (DETAJEN RREGULLAT)

**SHTOHET:** Subjektet zgjedhore janë të detyruara të paraqesin Raport Financiar për fushatën zgjedhore në KQZ brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. Raporti duhet të përmbajë informacion në lidhje me: i) Çdo dhurim që i është bërë partisë/subjektit zgjedhor (duke përfshirë edhe degët dhe kandidatët e saj) gjatë fushatës zgjedhore dhe gjashtë muaj para fushatës dhe burimin e tij, përfshirë edhe dhurimet apo shërbimet në natyrë. Të ardhurat për qëllime të fushatës zgjedhore nga të gjitha burimet e tjera të lejuara. Të gjithë zërat e shpenzimeve për qëllime të fushatës zgjedhore siç përcaktohen në vendimin e KQZ-së dhe në nenin 90, pika 3 të këtij Kodi.

Bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve.

**SHTOHET:** Çdo parti politike që merr pjesë në zgjedhje mban dhe ruan në arkivë për një periudhë prej 7 vjetësh, dokumentacionin e plotë dhe të hollësishtëm të statusit të saj financiar dhe të degëve të saj.

## 11. SHPENZIMET E FUSHATËS, KOMPETENCA TË REJA PËR KQZ

**SHTOHET:** KQZ ka të drejtën të verifikojë drejtpërdrejt shpenzimet e fushatës zgjedhore për çdo parti politike të regjistruar si subjekt zgjedhor, kandidatët apo kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, ose të verifikojë raportin e auditimit sipas pikës 1 të këtij neni. KQZ-ja për zbatim të këtij neni ka të drejtë të kërkojë të dhëna, dokumente apo informacion nga subjektet zgjedhore apo persona të tretë, të cilët duhet t'i përgjigjen kërkesës së KQZ-së brenda 15 ditëve nga marrja e saj. Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumentave, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohet administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të këtij Kodi.

## 12. MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE (SHTOHET NENI)

**SHTOHET:** Jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve, KQZ-ja cakton një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës dhe detyrimeve të tjera sipas nenit 4 të këtij Kodi. Monitoruesit duhet të përgjigjen nga personat me përvojë në vëzhgimin e zgjedhjeve.

**SHTOHET:** KQZ-ja krijon dhe mirëmban për periudhën 6 muaj para datës së zgjedhjeve deri në gjashtë muaj pas datës së zgjedhjeve portalin

në internet, me akses të lirë, për të denoncuar prej kujtdo shkeljet e mundshme të këtij Kodi nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët në lidhje me financimin e fushatës.

## 13. NDËRPRERJA OSE DJEGIA E MANDATIT

**ISHTE:** Mandati i ndërprerë i deputetit ose i anëtarit të këshillit të bashkisë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë të gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Ky rregull nuk aplikohet kur emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar.

**BËHET:** Mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të këtij Kodi, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë të gjinisë përkatëse pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini. Në rast se emrat e gjinisë përkatëse kanë shteruar mandati i kalon kandidatit të gjinisë përkatëse të partisë politike të koalicionit me herësin më të lartë. Ky proces zëvendësimi vijon duke garantuar përherë plotësimin e vakancës vetëm me kandidate të së njëjtës gjini. Në rastin e partisë politike që ka konkurruar e vetme në zgjedhje dhe kur vakanca nuk plotësohet nga gjinia më pak e përfaqësuar atëherë partia politike ndëshkohet nga KQZ-ja me gjobë në shumën 2 milion lekë.

## 14. SANKSIONE NË LIDHJE ME FINANÇIMIN E FUSHATËS

**ISHTE:** Shkelja e dispozitave për financimin e fushatës zgjedhore nga ana e përgjegjësit

të financës të partisë politike ndëshkohet me gjobë nga 50,000 deri në 100,000 lekë.

**BËHET:** Nga 100 000 deri 200 000 lekë.

**ISHTE:** Mosbashkëpunimi me auditin e KQZ-së nga ana e subjektit zgjedhor dënohet me gjobë nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë.

**BËHET:** Gjobë nga 2 000 000 deri 3 000 000 lekë, si dhe me pezullim të financimit publik të partisë politike për deri në 5 vjet.

**SHTOHET:** Mosparaqitja e një raporti financiar për fushatën brenda afatit ligjor dënohet me një gjobë prej 2 000 000 lekë. Paraqitja e raporteve në shkelje të formateve të standardizuara të miratuara nga KQZ-ja dënohet me gjobë prej 500 000 deri 1 000 000 lekë.

**SHTOHET:** Fondet jopublike të përfuara nga një parti politike, identiteti i dhuruesit të të cilave nuk dihet ose nuk përcaktohet qartësisht, transferohen në llogarinë e KQZ-së. Moskalimi çon në konfiskimin e fondeve të marra dhe në një gjobë të barabartë me shumën e fondeve të marra.

**SHTOHET:** Pranimit i fondeve private me vlerë më të madhe se 30 mijë lekë dhe kur transaksioni nuk është bërë përmes llogarive bankare dënohet me një gjobë të barabartë me shumën e dhuruar dhe në kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së.

**SHTOHET:** Pranimit i fondeve nga donatorë të ndaluar siç specifikohet në nenin 89, pika 3 dënohet me kalimin e fondeve të marra për llogari të KQZ-së dhe me një gjobë të barabartë me dyfishin e shumës së fondeve të marra.

**SHTOHET:** Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme e gjatë procesit të verifikimit nga KQZ-ja sipas nenit 91, paragrafi 6 ndëshkohet me gjobë nga KQZ-ja prej 100 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.

**SHTOHET:** Shkelja e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor dënohet me një gjobë prej 5 000 000 lekë ose me një gjobë të barabartë me shumën që ka kaluar kufirin, cilado që është më e lartë.

# Basha shpenzoi 9% të buxhetit të PD kundër ambasadores së SHBA

## Ja ku i mori paratë kreu i PD për të lobuar kundër Kathleen Ann Kavalec, e propozuar për ambasadore në Tiranë, fshehu shpenzimin

Shqiptarja.com dhe Report TV zbulojnë burimin e shumës prej 40 mijë USD, të përdorura nga kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, për të lobuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër emërimit të Kathleen Ann Kavalec, e propozuar për pozicionin e ambasadores amerikane në Tiranë. Në qershor të vitit 2018, Basha firmosi një kontratë lobimi me vlerë 40 mijë dollarë me kompaninë "Sonoran Policy Group", për të bllokuar kandidaturën e Kathleen Ann Kavalec. Për të financuar këtë kontratë, Lulzim Basha ka shpenzuar 9 për qind të parave të buxhetit të Partisë Demokratike për vitin 2018. Totali i të ardhurave të Partisë Demokratike për vitin 2018 është 52 094 711 lekë, nga të cilat 50 080 408 nga buxheti i shteti i shtetit dhe 2 014 303 nga kuotat e anëtarësimit. Në raportin financiar që Partia Demokratike ka dorëzuar në Komisionin Qendror të

### Basha

Lulzim Basha ka shpenzuar 9% të buxhetit të PD për vitin 2018 për të lobuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër emërimit të Kathleen Ann Kavalec, e propozuar për pozicionin e ambasadores amerikane në Tiranë.

Zgjedhjeve nuk specifikohet ndonjë shumë e caktuar për lobim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në raport jepet vetëm shuma 4 853 230 në zërin 'shërbime konsulence'. Për këtë arsye, Shqiptarja.com iu drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke i kërkuar informacion nëse kishte 'depozituar Partia Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, gjatë

vitit 2018, dokumentacion për shpenzimin e shumës prej 40 mijë USD për lobim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës'. Pas disa muajsh rezistencë për të mos dhënë sqarime, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më në fund, i urdhëruar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, informon Shqiptarja.com se "Ekspertja Silvana Gjikhima ka audituar fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia Demokratike. Nga komunikimi me ekspertin në lidhje me çështjen që ju pretendoni, ekspertja shprehet se kjo shumë është përfshirë në raportin e Partisë Demokratike në zërin 'shpenzime konsulence'. Duke e marrë si të mirëqenë përgjigjen e KQZ-së, kreu i PD ka shpenzuar 9% të të ardhurave të partisë, për të lobuar kundër kandidatës për ambasadore të SHBA-së në Shqipëri.


### SI U ZBULUAR KONTRATA

Kompania "Sonoran Policy Group" ka deklaruar në

### Fshehja

Në raportin financiar që Partia Demokratike ka dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk specifikohet ndonjë shumë e caktuar për lobim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

30 janar 2019 detajet e lobimit për interes të Partisë Demokratike pranë Departamentit Amerikan të Drejtësisë. Një vëmendje e veçantë e fushatës lobuese të kësaj kompanie për interes të Bashës është bërë për sa i përket të nominuarës për ambasadore në Shqipëri si dhe çështjeve që lidhen me sigurinë, narko-trafikun dhe terrorizmin. Sipas detajeve të siguruar nga Shqiptarja.com dhe Report TV, shefi ekzekutiv i kom-



panisë, Christian Bourge ka kryer 3 telefonata, 3 takime në totale për llogari të PD-së me senatorët amerikanë. Këto takime dhe biseda janë kryer me anëtarët e Senatit amerikanë për Politikën e Jashtme, të cilët po shqyrtonin dokumentacionin e kandidaturës Kathleen Kavalec për ambasadore në vendin tonë. Konkretisht, shefi ekzekutiv, Christian është takuar me senatorin Rob Portman, anëtar i

Komitetit për Politikën e Jashtme në Senat, i cili rezultoi të jetë i përfshirë direkt në procesin e shqyrtimit të kandidatës së Kavalec. Por edhe pse Kavalec ishte e nominuar e Presidentit amerikan Donald Trump, si dhe u përfol gjatë nga mediat amerikane si ambasadorja e re e SHBA në Shqipëri, emri i saj nuk kaloi dot Kongresin Amerikan duke mos u zgjedhur në këtë mënyrë si shefe e diplomacisë amerikane në vendin tonë.

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

## Denoncimet për Pjetrin, Kajmakun e Babanin, PD sulmon Prokurorinë

Partia Demokratike me anë të një reagimi ka hedhur akuza ndaj Prokurorisë duke thënë se nuk po zbaton ligjin dhe po zvarrit çështjet për kandidatët dhe kryetarët e bashkive që PD ka denoncuar si të përfshirë në ngjarje kriminale. Sipas PD duke nisur që nga 1 gushti, kjo parti pretendon se ka paraqitur prova se kandidatët e Edi Ramës në bashkitë Shkodër, Valdrin Pjetri, Vorë, Agim Kajmaku dhe në bashkinë Vau i Dejës, Mark Babani kanë të kaluar kriminale dhe si të tillë duhet të largohen dhe të ndiqen penalisht për falsifikim të formularit të dekriminalizimit. PD, e konsideron mosveprimin prej më shumë se 2 muaj të prokurorisë si përpjekje për të mbrojtur njerëzit e inkriminuar të Edi Ramës në bashki. Ndër të tjera në reagimin e PD thuhet se mbrojtja e këtyre personave nga Prokuroria del në pah nga një letër e Sekretarit të Përgjithshëm të PD, Gazment

Bardhi, për Prokurorinë e Përgjithshme, e cila i çohet për dijeni edhe KLP-së që vlerëson punën e Prokurorit të Përgjithshëm, ambasadsë së SHBA, BE, OSBE dhe Këshillit të Evropës. Sipas ligjit, deklarimet e rreme në formularin e dekriminalizimit dënohen me burg nga 6 muaj deri në 4 vjet. PD ka kërkuar në 5 Shtator që t'i vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni që tregon veprimet e prokurorisë për të bërë verifikimin e 3 denoncimeve të bëra nga PD. "Organi i prokurorisë në shkelje flagrante të ligjit, edhe pse afati është tejkaluar disa herë, ende nuk ka vënë në dispozicion të kërkuarit dokumentacionin e kërkuar, duke na pamundësuar ushtrimin e të drejtave tona ligjore dhe duke mos bërë transparencë për opinionin publik mbi këto raste", thuhet në kërkesën e re për informacion që Sekretari i Përgjithshëm i PD i dërgon Prokurorisë së Përgjithshme. "Kjo sjellje e



organit të prokurorisë ngre dyshime të arsyeshme mbi tentativën shtetërore për marrjen në mbrojtje të personave të inkriminuar që kanë arritur, me mbështetjen e partisë në pushtet, të uzurpojnë funksionet publike, në kundërshtim flagrant me ligjin e dekriminalizimit", theksohet në kërkesën e PD. Duke kërkuar edhe një herë zyrtarisht informacion për procedurat e ndjekura nga prokuroria për të tria rastet, PD u bën thirrje prokurorëve të ngarkuar me këtë çështje, të mos i nënshtrohen presionit politik të Edi Ramës dhe Arta Markut.

## E propozuara për ambasadore në Shqipëri në 29 Tetor para Senatit

Diplomatja Yuri Kim, që është propozuar nga Presidenti amerikan Donald Trump për ambasadore në Tiranë do të dalë në një seancë dëgjimore para Senatit në datë 29 tetor. Seancë dëgjimore në komisionin e jashtëm të Senatit është pengesa e fundit përpara se Kim të marrë miratimin për të udhëtuar drejt Shqipërisë në detyrën e re. Kim u propozua nga Trump në qershor për të zëvendësuar Donald Lu. Ajo është një diplomate karriere që ka mbajtur funksione të ndryshme dhe detyra të larta në shërbimin e jashtëm amerikan. Yuri Kim me origjinë aziatiko-amerikane është zyrtare e lartë e shërbimit të jashtëm amerikan, e cila ka punuar në poste kryesore dhe ka mbuluar rajone të shumta, duke përfshirë Kinën, Korenë e Veriut, Turqinë, Irakun dhe

NATO-n. Në Departamentin e Shtetit ajo ka drejtuar zyrën e Evropës Jugore. Më herët ajo ka qenë drejtoreshë për qendrën e studimeve për diplomaci në DASH, si dhe shefe e kabinetit e zv.sekretarit të shtetit. Ajo ka shërbyer gjithashtu si asistente speciale e ndihmës sekretarit të shtetit për Azinë Lindore dhe Paqësorin. Në këtë rol, ka qenë pjesë e delegacionit amerikan në bisedimet shumëpalëshe mbi programin nuklear të Koresë së Veriut. Gjithashtu Kim ka qenë Konsulle Politiqe në Ankara dhe në Bagdad dhe anëtare e delegacionit të SHBA-së në bisedimet që synojnë denuklearizimin të Koresë së Veriut. Diplomatja Yuri Kim e propozuar nga presidenti Trump pritet të zërë vendin ambasadorit Donald Lu të larguar në maj të 2018-ës.





## MCALLISTER

“Unë shpresoj që 27 liderët e BE-së do të jenë në gjendje të bien dakord për këtë çështje gjatë presidencës së ardhshme, kur samiti i Ballkanit Perëndimor është planifikuar për majin e vitit 2020”



### Basha

“Hapja e negociatave është interesi më i madh i Shqipërisë sepse do të sjellë një mbikëqyrje të shtuar nga BE për ndarjen e politikës nga krimi, zgjedhje të lira dhe të ndershme, barazi para ligjit dhe fund pandeshkueshmërisë”.

## Kryeministri grek Mitsotakis: Pro integritet, por parakushti mbeten pakicat



Kryeministri i Grekisë, Mitsotakis shprehet se Athina është në favor të rrugës evropiane të Ballkanit Perëndimor, por ka rezerva për Shqipërinë tek çështja e pakicave, ndërsa për Maqedoninë, thotë se marrëveshja e Prespës ishte negative, megjithatë nuk do të ndërmarrë asnjë hap për tërheqje. “Greqia është në favor të rrugës evropiane të Ballkanit Perëndimor, jo vetëm sepse e shndërron perspektivën në një faktor stabiliteti në rajon, por edhe sepse është një levë demokratike për modernizimin e nevojshëm të fqinjëve tanë dhe për zgjidhjen e çështjeve tona bilaterale. Unë ende besoj se Marrëveshja e Prespës ishte një marrëveshje negative për vendin tonë. Unë votova kundër, por sinjerisht i paralajmërova grekët se çfarë nënkuptonte nënkuptimi i saj. Por nuk do ta fyej edhe pse të tjerët e kanë nënshkruar. Unë as nuk do ta ekspozoj vendin në aventura. Pa rrezikuar destabilizimin më të vogël, ne do të monitorojmë nga afër detyrimet e fqinjëve tanë me detyrimet e tyre”, tha ai

për këtë vendim dhe duhet të shpjegojnë pse e morën atë”, tha ai. Në 2017 me paketën e njohur si ‘McAllister Plus’ ai zgjidhi krizën politike në Shqipëri pas çadrës që ngriti opozita para Kryeministrit.

### BASHA CITON MCALLISTER

Kryedemokrati Lulzim Basha ka reaguar pas deklarimit të eurodeputetit David McAllister i cili kritikoi vendimin e Francës për të vendosur veto

## Negociatat Ambasadori i ri austriak: Keqardhje që u shty vendimi



Evropën e quan të paplotë pa Ballkanin dhe nuk heziton të shprehë keqardhjen për shtyrjen e negociatave. Nga Shkodra ku mori pjesë në festën kombëtare të Austrisë, i ngarkuari me punë, i cili pas pak ditësh do të jetë ambasadori i ri, Christian Steiner rikonfirmoi mbështetjen e vendit të tij ndaj Shqipërisë. “Shërbimi im diplomatik për herë të parë në vendin tuaj ishte në vitet 96 - 97. Jeta atëherë nuk ka qenë e thjeshtë, sot shumë gjëra kanë ndryshuar për mirë. Megjithatë që në 1996 më ka impresionuar pozitivisht lidhjet në disa fusha Shqipëri - Austri. Kjo me duket e natyrshme duke pasur parasysh lidhjet historike. Jam i lumtur të shoh thellimin e këtyre marrëdhënieve kur shoh suksesin e shkollës austriake, një nga 8 institucionet arsimore tonat. Ministri ynë kur ishte në tetor këtu ka shprehur mbështetjen për integrimin evropian. Na vjen keq që vendimi është shtyrë pasi të dy vendet kanë punuar mirë. Europa nuk është e plotë me mungesën e vendeve të Ballkanit”, tha Christian Steiner.

për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Basha thotë se hapja e negociatave do të sjellë një mbikëqyrje të shtuar nga BE për ndarjen e politikës nga krimi dhe se rruga e vetme për të shkuar në BE është përmbytja e kushteve të vendosura nga Bundestagu. “Hapja e negociatave është interesi më i madh i Shqipërisë sepse do të sjellë një mbikëqyrje të shtuar nga BE për ndarjen e politikës nga krimi, zgjedhje të lira dhe të ndershme, barazi para ligjit dhe fund pandeshkueshmërisë. Rruga e vetme përpara është përmbytja e kushteve të vendosura nga Bundestagu gjerman. 9 kushtet e Bundestagut janë udhërrëfyesit e daljes nga kriza dhe i afrojnë të Shqipërisë me BE. Mirënjohje familjes tonë politike Partisë Popullore Evropiane për mbështetjen që i jep Shqipërisë dhe shqiptarëve”, shkruan Basha.

# McAllister: Duhej bindur Macroni, shpresoj të hapen në 2020

## Lulzim Basha citon McAllister: 9 kushtet e Bundestagut, udhërrëfyes për daljen nga kriza dhe afrimin me BE

### Konferenca

## Rama tregon historinë me zyrtarin e BE: Kërkonte mbrojtje me kallash

U zhvillua dje në ambientet e Pallatit të Kongreseve Konferenca e 41-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë. Në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe kryeministri Rama i cili ka falënderuar të gjithë të pranishmit dhe ka thënë se është besim plotë që do të arrihen rezultate serioze në përfundim të kësaj konference. Por në fjalën e tij kryeministri Rama ka shënjestruar edhe hotel ndërkombëtare në Shqipëri. Duke folur në këtë konferencë Rama ka dalë jashtë fjalimit të që kishte para përgatitur. Ai ka folur rreth një vizite në Shqipëri të një personaliteti nga Bashkimi Evropian i cili kishte patur frikë fillimisht. Kryeministri tregoi se i ishte dashur ta shoqëronte me eskortë të blinduar, por më pas ai kishte mbetur i habitur me Shqipërinë dhe kishte thënë se priste gjithçka ndryshe. Kryemi-



nistri deklaroi se në Shqipëri asnjë i huaj nuk është prekur dhe nuk do të preket. Duke ‘thumbuar’ hotelet ndërkombëtare, kryeministri tha se e vetmja gjë që mund të vjedhë të huaj janë pikërisht këto hotele ndërkombëtare. “E vetmja mënyrë si mund të të vidhnin në Tiranë është te faturat e hoteleve ndërkombëtare se ju tarifojnë siç nuk ju kishte shkuar mendja dhe pastaj fshihen në stereotipin e saj. Në vendin tonë asnjë i huaj nuk preket. Paragrafi ynë është që Shqipëria e shqiptarëve i përket Zotit dhe të ftuarve dhe në qoftë se nuk vjen zoti vetë i ftuari është zoti. E vetmja gjë që mund t’ju them është kujdes me faturat celulare”, theksoi kryeministri ndër të tjera. Më pas Rama ka thënë se të gjithë të pranishmit në këtë konferencë do të jenë të gatshëm të flasin fjalë të mira për vendin tonë duke ua sugjeruar edhe miqve.

David McAllister, politikan gjerman, anëtar i Parlamentit Evropian, pjesë e Partisë Popullore Evropiane dhe Kryetar i Komitetit të Punëve të Jashtme të PE-së ka kritikuar vendimin e Francës për veton për Shqipërinë dhe Maqedoninë për hapjen e negociatave. “Para së gjithash, ne po flasim vetëm për fillimin e negociatave. Përfundimi i tyre do të zgjaste shumë vite, kështu që vetëm fillimi i bisedimeve me Maqedoninë Veriore dhe Shqipërinë nuk do të thotë që këto vende do të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian nesër. Së dyti, presidenti francez në argumentin e tij theksoi se ai ishte kundër bisedimeve të pranimit, sepse ai besonte se BE së pari duhet të rishikojë procesin e zgjerimit. Jam dakord që ka gjëra që mund të bëjmë më mirë në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, unë shpresoj që 27 liderët e BE-së do të jenë në gjendje të bien dakord për këtë çështje gjatë presidencës së ardhshme, kur samiti i Ballkanit Perëndimor është planifikuar për majin e vitit 2020. Ndoshta atëherë do të ketë një përparim në bisedime dhe do të negociohet një dritë jeshile për Maqedoninë Veriu dhe Shqipëria. Shpresoj kështu. Sipas mendimit tim, zgjidhja më e mirë do të ishte një rrugë e ngjashme me rezolutën e miratuar nga Bundestagu gjerman - drita jeshile për Maqedoninë Veriore dhe dritë jeshile e kushtëzuar për Shqipërinë. Vlen të përmendet se politika e zgjerimit ngjall shumë dyshime në Gjermani, dhe Bundestag gjerman ka vendosur të ndjekë këtë rrugë. Kjo është një arsye tjetër pse unë jam aq i zhgënjyer që Gjermania, e cila ka treguar udhëheqje në këtë fushë, nuk ka arritur të bindë partnerët tanë francezë. Macron, Rutte dhe të tjerët janë përgjegjës

# Bashkitë 50 milionë euro borxhe, qeveria bën gati administratorët

GENC KONDI  
TIRANE

## Afat deri në fund të vitit për të rregulluar bilancet e tyre financiare

**M**e një veprim jo të zakonshëm, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka paralajmëruar ato bashki, që kanë krijuar më shumë detyrime, se do t'i propozojë Këshillit të Ministrave të caktojë administratorë nga pushteti qendror për të menaxhuar buxhetet e tyre, me qëllimin e uljes së borxheve të prapambetura. Ky paralajmërim është bërë në një Udhëzim të datës 27 shtator nga ministria e Financave Anila Denaj, dërguar 61 bashkive. Sipas Udhëzimit, në muajin dhjetor do të ngrihet një grup pune, që duhet të konstatojë bashkitë me më shumë probleme financiare, i cili në fund të vitit do të përgatitë raportin zyrtar, në bazë të të cilit do të veprojë qeveria. Kështu, bashkitë do të kenë afat deri në fund të dhjetorit të rregullojnë situatën e tyre financiare, ose do t'i nënshtrohen administrimit nga qeveria.

### VËSHIRËSITË FINANCIARE

Por si parashikohet të procedohet në rastin e borxheve të bashkive? Sipas Udhëzimit, njësia e vetëqeverisjes vendore

konsiderohet me probleme financiare kur në një muaj të caktuar të vitit buxhetor konstatohen vonesa prej më shumë se 30 ditësh në likuidimin e detyrimeve financiare ndaj palëve të treta dhe kur detyrimet e konstatuara dhe të papaguara përbëjnë 15 për qind të shpenzimeve vjetore të miratuara. Bashkia konsiderohet në vështirësi serioze financiare kur borxhet afatgjata dhe detyrimet e papaguara ndaj palëve të treta përbëjnë mbi 80 për qind të shpenzimeve buxhetore vjetore të miratuara.

Sipas ligjit, kryetari i bashkisë, me konstatimin e situatës së vështirësisë serioze financiare, njofton Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila njofton menjëherë Këshillin e Ministrave. Këshilli i Ministrave mund të shpallë brenda 15 ditësh bashkinë në mbikëqyrje financiare dhe të autorizojë Ministrinë e Financave dhe

Ekonomisë si mbikëqyrës financiar të saj, duke respektuar rigorozisht këto kushte: njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të marrë asnjë vendim që mund të çojë në shtimin e detyrimeve të saj financiare; njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të vendosë shërbime të reja publike, të themelojë sipërmarrje publike apo çdo institucion tjetër; njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të shlyejë asnjë detyrim financiar, të krijuar para shpalljes së rastit të vështirësisë financiare. Sipas Udhëzimit, detyrimet e krijuara para vitit 2015 nga bashkitë, për të cilat ka mangësi apo pasaktësi në dokumentacion, ose nuk figurojnë të regjistruara në librat e kontabilitetit të asaj bashkie, nuk trajtohen nga procedurat që parashikon Udhëzimi.

### ADMINISTRATORI

Sipas Udhëzimit, mbikëqyrë-

si financiar (administratori) ka të drejtë ndër të tjera të japë urdhra brenda administratës vendore, njësive të varësisë ose entiteteve të jashtme publike për zbatimin e planit të rehabilitimit financiar; të kryesojë negociatat me kreditorët dhe furnitorët për ristrukturimin e borxhit dhe riorganizimin e detyrimeve të papaguara ndaj të tretëve, me pjesëmarrje edhe të përfaqësuesve të pushtetit vendor, etj.

### BORXHET

Sipas statistikave zyrtare të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, aktualisht detyrimet e papaguara të 61 bashkive të vendit kanë arritur në rreth 6.2 miliardë lekë, ose mbi 50 milionë euro. Kjo shifër rezulton në ulje rreth 7.8% krahasuar me stokun në fund të vitit 2018, megjithatë mbetet një shqetësim serioz. Bazuar në informacionin e publikuar nga MFE, rreth 47% e stokut të detyrimeve të prapambetura përfaqësohet nga investimet, 21% nga detyrime për mallra dhe shërbime, rreth 18% nga vendime gjyqësore dhe 11% nga detyrime të tjera.

Në ndarjen sipas bashkive, 9 bashki mbajnë rreth 64.6% të stokut total të detyrimeve të prapambetura. Niveli më i lartë i detyrimeve të prapambetura u shënuar në bashkinë Tiranë me rreth 1.9 miliard lekë apo 30.1% e stokut total, ndjekur nga bashkia Pogradec me rreth 409.5 milionë lekë apo 6.6% e stokut total; bashkia Kavajë me rreth 406.1 milionë lekë apo rreth 6.5% e stokut total dhe bashkia Vlorë me rreth 403.9 milionë lekë apo rreth 6.4% e stokut total të detyrimeve të prapambetura në fund të muajit qershor 2019. Por duket se edhe në fund të 9-mujorit situata nuk ka ndryshuar, duke detyruar ministrinë të përgatitet të emërojë administrator të posaçëm.

Krahasuar me fundin e vitit 2018, stoku i detyrimeve të prapambetura rezulton të jetë rritur veçanërisht në bashkitë Finiq (+46.1 milionë lekë), Kuçovë (+25.5 milionë lekë), Roskovec (+51.4 milionë lekë) dhe Skrapar (+25.3 milionë lekë).

Në të kundërt, disa bashki kanë shlyer një pjesë të mirë të detyrimeve të prapambetura, ndër të cilat bashkitë: Tiranë (-120.8 milionë lekë), Lezhë (-95.1 milionë lekë), Kamëz (-79.5 milionë lekë), Bulqizë (-76.7 milionë lekë), Mat (-49.6 milionë lekë), Mirditë (-47.2 milionë lekë), Ura Vajgurore (-51.6 milionë lekë) etj.

## DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË BASHKIVE DERI NË FUND TË QERSHORIT 2019

në lekë

NR.	BASHKIA	DETYRIMI I MBETUR
1	Bashkia Belsh	15,440,911
2	Bashkia Berat	26,493,635
3	Bashkia Bulqizë	53,048,109
4	Bashkia Cërrik	44,638,324
5	Bashkia Delvinë	23,763,866
6	Bashkia Devoll	16,385,564
7	Bashkia Dibër	230,918,967
8	Bashkia Divjakë	19,453,696
9	Bashkia Dropull	21,236,975
10	Bashkia Durrës	257,696,169
11	Bashkia Elbasan	132,400,807
12	Bashkia Fier	126,081,021
13	Bashkia Finiq	94,972,621
14	Bashkia Fushë-Arrëz	16,989,815
15	Bashkia Gjirokastrë	38,007,090
16	Bashkia Gramsh	18,779,211
17	Bashkia Has	18,900,565
18	Bashkia Himarë	17,341,305
19	Bashkia Kamëz	209,911,578
20	Bashkia Kavajë	406,060,795
21	Bashkia Këlcyrë	0
22	Bashkia Klos	27,488,638
23	Bashkia Kolonjë	14,122,433
24	Bashkia Konispol	108,606,694
25	Bashkia Korçë	16,658,845
26	Bashkia Krujë	61,670,912
27	Bashkia Kuçovë	63,305,960
28	Bashkia Kukës	103,375,726
29	Bashkia Kurbin	35,304,299
30	Bashkia Lezhë	240,034,449
31	Bashkia Libohovë	11,883,535
32	Bashkia Librazhd	89,583,024
33	Bashkia Lushnjë	139,829,889
34	Bashkia Malësi e Madhe	19,546,058
35	Bashkia Maliq	4,752,220
36	Bashkia Mallakastër	24,039,110
37	Bashkia Mat	25,299,742
38	Bashkia Memaliaj	22,979,336
39	Bashkia Mirditë	62,911,578
40	Bashkia Patos	0
41	Bashkia Peqin	24,123,794
42	Bashkia Përmet	4,500,261
43	Bashkia Pogradec	409,492,562
44	Bashkia Poliçan	42,108,944
45	Bashkia Prrenjas	35,743,814
46	Bashkia Pukë	34,362,811
47	Bashkia Pustec	5,216,112
48	Bashkia Roskovec	86,904,528
49	Bashkia Rrogozhinë	105,583,472
50	Bashkia Sarandë	37,233,211
51	Bashkia Selenicë	39,056,836
52	Bashkia Shijak	1,693,200
53	Bashkia Shkodër	51,922,676
54	Bashkia Skrapar	61,088,270
55	Bashkia Tepelenë	29,820,006
56	Bashkia Tiranë	1,876,803,412
57	Bashkia Tropojë	27,563,516
58	Bashkia Ura Vajgurore	84,468,808
59	Bashkia Vau i Dejës	9,445,588
60	Bashkia Vlorë	403,924,453
61	Bashkia Vorë	10,815,524
	<b>TOTAL</b>	<b>6,241,785,270</b>






## INFO-TAG

### Panairi i informacionit rreth Gjermanisë

**Shkollime, studime, praktika, bursa, kërkim shkencor, mësimi i gjermanishtes, etj.**

**Kur?** E premte, 18 tetor 2019  
mund të vini të informoheni në çdo kohë nga ora 10:00 deri në 16:00.

**Ku?** Europe House,  
Rruga Papa Gjon Pali II (përballë Coin/Aba).

Për informacione të mëtejshme vizitoni: [www.tetori-gjerman.com](http://www.tetori-gjerman.com)



Deutscher Akademischer Austauschdienst  
German Academic Exchange Service



Study in Germany  
Land of Ideas  
[www.study-in.de](http://www.study-in.de)



IPS  
Internationales Parlaments-Stipendium  
des Deutschen Bundestages



GOETHE-ZENTRUM  
KOOPERATIONSPARTNER  
GOETHE INSTITUT



ATE osd



oead oa



30 bashkëpunimi gjerman  
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEITUNG



# Veliaj: Nuk do të ketë ndërtime në Kopshtin Botanik

**Nga Parku Olimpik ku nisi turi i dëgjesave në çdo njësi për projektbuxhetin 2020, kryebashkiaku deklaroi se e gjithë zona do të ketë një mbrojtje të veçantë**

**K**opshti botanik jo vetëm që do të ruhet, por edhe do të shfrytëzohet më mirë nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe do të vihet në dispozicion të qytetarëve të Tiranës. Nga Parku Olimpik i Tiranës, ku nisi turi i dëgjesave në çdo njësi për projektbuxhetin e vitit 2020, Kryebashkiaku Veliaj deklaroi se nuk do të ketë ndërtime, përkundrazi e gjithë zona do të ketë një mbrojtje të veçantë që nuk e ka pasur për gjithë këto vite ku është zaptuar.

“Lajmin e mirë që keni marrë vesh të gjithë banorët në njësinë 5 ka të bëjë me megainvestimin që ne do të fillojmë në Kopshtin Zoologjik dhe në Kopshtin Botanik, të dyja prona

me hipoteke, të Bashkisë së Tiranës dhe të dyja zona jashtëzakonisht problematike. Për të gjithë ata që tmerrohen thonë që në kopshtin Botanik do ndërtohen kulla, mjafton të shihni perimetrin e kopshtit Botanik dhe të shihni se si tashmë është zaptuar. Kjo që ndodhi, që Bashkia e Tiranës mori administrimin nga qeveria të Kopshtit Botanik pikërisht vjen me këtë kusht që në mbrojtjen e Bashkisë nuk mund ta zaptojë më njeri. Nëse mendonin që po e ruanin, bëni një xhiro në itinerar dhe do shikoni se si është shqyer në të gjithë anët Kopshti Botanik. Nuk ndërrohet destinacioni, nuk do ketë asnjë ndërtim por më në fund të njëjtin stil menaxhimi që Bashkia

e Tiranës ka për kryevepra si Parku Olimpik do e çojë edhe tek kopshti Zoologjik dhe Botanik”, tha Veliaj. Kreu i Bashkisë i kërkoi politikës që të qëndrojë larg punëve publike të qytetit.

“Çfarë mund të bëhet ku politika fut hundët në punët komunale?! Këtu merret edhe presidenti, kryetari i opozitës dhe këta lloj deputetësh njerëz që s’kanë haberin fare dhe as janë votuar për këtë punë në vend që të bëjnë punë e tyre dëshirojnë të bëjnë punën time, të drejtorit të komunales. Kështu që për të gjitha këto arsye, për këto që do të ndezë flakë te kopshti botanik jap fjalën e burrit do zhgënjeheni totalisht se ajo do dalë kryevepër dhe do dilni

prapë huq si te lodrat, si te shkolla Kosova, si te Pazari, si te Kalaja, si te bulevardi i ri, si te amfiteatri”, deklaroi Veliaj, teksa nënvizoi se aktualisht duhet të japësh lekë në dorë që të futesh brenda kopshtit botanik për të bërë një foto. “Sot duhet të japësh një korrupsion të vogël të të lërë të bësh fotot ditët e dasmës, ka vetëm nuse ditën e dasmës dhe tenderat e rojeve, nuk shkon kjo. Mezi pres të fillojë faza e parë te kopshti zoologjik dhe pastaj faza e dytë te kopshti botanik për ta bërë njësinë 5 akoma më atraktive dhe për t’ia rritur vlerën pronës në këtë njësi. Kopshti Zoologjik dhe Botanik ende nuk e kanë parë investimin, por deri më tani kanë qenë administrim

ndryshe. Kopshti Zoologjik edhe pa investimin e madh që do bëjmë I sillte Bashkisë së Tiranës vetëm duke qenë nikoqir, duke mbledhur faturat, biletat, I sillte Bashkisë së Tiranës 15 milionë lekë në vit; ndërkohë pra të paktën paguante veten, mirëmbajtjen dhe ushqimin e kafshëve; ndërkohë prapë pa investim, vetëm në vitin e fundit, Kopshti Botanik ka mbledhur 150 mijë lekë të vjetra, as gjysmën e rrogës për një roje, 150 mijë lekë të vjetra, pra po ta pjesëtojmë për 300 ditë, 500 lekë, pra një monedhë 50 lekëshe në ditë, pra prona në zemër të njësisë 5 gjeneron 50 lekë të vjetra në ditë, një kaush me fara, një paketë çumçakiz. A ka sens kjo?”, deklaroi Veliaj.



## DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE GJIROKASTËR

### NJOFTIM

1. Institucioni Drejtoria Rajonale e Kultures Kombetare Gjirokastrë, njofton subjektet e interesuara, të liçensuara për restaurim, të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkursin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Objekti që do të restaurohet është: “Ndërhyrje Restauruese në Kroin e Selckës” Monument Kulture Kategoria e Parë, i cili ndodhet në fshatin Selckë, Njësia Administrative Pogon, Bashkia Dropull, Gjirokastrë.
3. Fondi limit i vënë në dispozicion **1.563.616 (Një milionë e pesëqint e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqint e gjashtëmbëdhjetë) lekë (pa TVSH)**. Projekti është Financuar me fondet e Ministrisë së Kulturës, vendosur në dispozicion nga të ardhurat e Institucionit, të krijuara gjatë vitit 2019
4. Data e përfundimit të restaurimit **30 (tridhjetë) ditë**, nga data e lidhjes së kontratës.
5. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data **29.10.2019, ora 10:00**, në Zyrën e Protokollit të institucionit. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
6. Kandidatët e interesuar mund të inspektojnë dokumentat e restaurimit, çdo ditë nga ora **10:00 deri 14:00**, pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
7. Dokumentat standarde të restaurimit mund të tërhiqen pranë institucionit në bazë të kërkesës me shkrim nga ora **10:00 deri 14:00**.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumenta ligjorë dhe administrativë origjinalë ose kopje të noterizuara si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentat standarde të restaurimit, të miratuara për këtë qëllim.
9. Ofertat do të shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit në datë **29.10.2019, ora 13:00** në DRKK Gjirokastrë, Zyra Teknike.
10. Përfaqësues të autorizuar me shkrim të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e Ofertave.



## DREJTORIA RAJONALE E KULTURËS KOMBËTARE GJIROKASTËR

### NJOFTIM

1. Institucioni Drejtoria Rajonale e Kultures Kombetare Gjirokastrë, njofton subjektet e interesuara, të liçensuara për restaurim, të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkursin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Objekti që do të restaurohet është: “Ndërhyrje Restauruese në Shtëpinë e ANDON Z. ÇAJUPI” Monument Kulture Kategoria e Parë, ndodhur në fshatin Sheper, Njësia Administrative Zagorie, Bashkia Libohovë, Gjirokastrë.
3. Fondi limit i vënë në dispozicion **5.134.102 (Pesë milionë e njëqint e tridhjetë e katër mijë e njëqint e dy) lekë (pa TVSH)**. Projekti është Financuar me fondet e Ministrisë së Kulturës, vendosur në dispozicion nga të ardhurat e Institucionit, të krijuara gjatë vitit 2019.
4. Data e përfundimit të restaurimit **45 (dyzetë e pesë) ditë**, nga data e lidhjes së kontratës.
5. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data **29.10.2019, ora 10:00**, në Zyrën e Protokollit të institucionit. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
6. Kandidatët e interesuar mund të inspektojnë dokumentat e restaurimit, çdo ditë nga ora **10:00 deri 14:00**, pranë Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
7. Dokumentat standarde të restaurimit mund të tërhiqen pranë institucionit në bazë të kërkesës me shkrim nga ora **10:00 deri 14:00**.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumenta ligjorë dhe administrativë origjinalë ose kopje të noterizuara si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentat standarde të restaurimit, të miratuara për këtë qëllim.
9. Ofertat do të shqyrtohen nga komisioni i vlerësimit në datë **29.10.2019, ora 11:00** në DRKK Gjirokastrë, Zyra Teknike, kati i dytë.
10. Përfaqësues të autorizuar me shkrim të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e Ofertave.

# Zbulohet celula terroriste iraniane, në krye bos i drogës

18 muaj pas parandalimit të një sulmi gjatë kremtimit të festës së sulltan Nevruzit në Tiranë parandalohet sulmi ndaj muxhahedinëve të MEK në Shqipëri në krye të grupit ishte trafikanti turk i drogës Abdulsalam Turgut

**N**jë rrjet terrorist i drejtuar nga regjimi iranian i njësive klandestine dhe sekrete të forcave revolucionare "QUDS" që kishte synim kryerjen e sulmeve ndaj opozitës iraniane MEK, refugjatë muxhahedinë të strehuar në Shqipëri, është zbuluar nga autoritetet e sigurisë në vendin tonë. Kjo celulë, siç bëri të ditur sot në një konferencë për mediat drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, drejtohet nga operativ i Forcave QUDS, i njohur si PEYMAN (nuk i dihen gjeneralitetet), rezident i përhershëm në Iran. Ai menaxhon në distancë një numër operativësh në Shqipëri dhe në vende të tjera në Evropën Qendrore dhe Perëndimore.

Operativët kriminalë të QUDS me bazë në Ballkan drejtohen nga një kriminel turk, trafikant ndërkombëtar droge, Abdulsalam Turgut, 52 vjeç, i arrestuar në 2011ën për llogari të Gjermanisë për 1 ton heroinë që u kap atje 2009-ën. Nga viti 2018, Turgut, i cili u arratis nga vendi ynë, ka dërguar në Shqipëri operativë të forcave revolucionare iraniane, për sulme kundër muxhahedinëve refugjatë në Shqipëri.


Zbulimi dhe identifikimi i kësaj celule bëri të parandalohet sulmi i planifikuar i marsit 2018 pranë Kryegjyshit gjatë kremtimeve të Festës së Nevruzit, të frekuentuar nga anëtarë të nivelit të lartë të organizatës opozitare iraniane Mujahedeen el Khalq (MEK). Dy iranianë me pasaporta gjermane, u arrestuan në atë kohë në ambientet e Kryegjyshit, por u liruan më tej pasi thanë se ishin gazetarë dhe larguan nga territori shqiptar. Burime për Shqiptarja.com thanë se pas lirimimit ata u vunë në hetim duke çuar në gjurmët e kokave që dirijonin celulën terroriste.

Një operativ i kësaj celule është një iranian që jeton në Turqi, shtet ku njihet me pseudonimin 'Ferhat', i cili ka bashkëpunuar atje me një nga figurat më të njohura të kriminit të organizuar turk për të planifikuar sulme terroriste me urdhër të Forcave QUDS dhe liderit të tyre, Peyman.

## POR ÇFARË E LIDH IRANIANIN ABDOLKHALEGH MALEK ZADEH DHE BASHKËPUNËTORIN E TIJ TURK ABDULSELAM TURGUT ME SHQIPËRINË?

Dy vitet e fundit, iranianin kishte bashkëpunuar me turkun Abdulsalam Turgut, i cili veç akuzave për trafik ndërkombëtar droge ka lidhje edhe

## Struktura e Celulës Terroriste



me krimin e organizuar në Shqipëri. Ai është arrestuar në vitin 2011 në Shqipëri për trafik të 1 ton heroinë, por me një vendim të dyshimtë, ju ndryshua masa e sigurisë nga "arrest me burg" në "arrest shtëpie", duke i hapur dyert e arratisë me një pasaportë false. "Një tjetër operativ, është Abdolkhalegh Malek Zadeh, një iranian që jeton në Turqi dhe që ka drejtuar celulën operacionale. Malek Zadeh (i njohur gjithashtu nga lidhjet kriminale me pseudonimin "Ferhat") ka vazhduar të punojë gjatë dy viteve të fundit me Abdulsalam Turgut, një figurë e njohur e kriminit të organizuar turk, për të planifikuar sulme terroriste me urdhër të PEYMAN-it dhe të Forcave QUDS. TURGUT, i njohur si një bos mafioz turk dhe kreu i një rrjeti të fuqishëm ndërkombëtar të trafikut të drogës është burgosur së fundmi në Azerbajxhan dhe në Turqi me akuzë për trafik droge. Turgut ka gjithashtu lidhje të vjetra me krimin e organizuar në Shqipëri. Turgut është liruar nga një burg në Turqi në fund të vitit 2018. Në vitin 2011, Turgut është burgosur gjithashtu në Shqipëri me akuzë në lidhje me trafikimin e

dyshuar të rreth 1 ton heroinë, por u arratis nga vendi duke përdorur një pasaportë false, pasi gjykata ndërroi masën e sigurisë nga "Arrest në burg" në "Arrest shtëpie". Operativët kriminelë, me bazë në Ballkan, që janë vartës të Turgut-it ose të një trafikanti droge turk të lidhur me të, nga viti 2018, janë dërguar në Shqipëri për të avancuar planifikimin e sulmeve kundër MEK-ut, siç ishte diktuar nga MALEK ZADEH dhe Forcat QUDS", tha kryepolici Veliu.

## PEYMAN INFILTRIOI BRENDA MEK NË SHQIPËRI IRANIANIN ME PASAPORTË AUSTRIAKE

Një prej operativëve të kësaj celule ishte i infiltruar në mesin e vetë anëtarëve të MEK me pasaportë austriake për të zbuluar aktivitetet që opozita iraniane do të mbante në Shqipëri, si objektiva të mundshëm për të kryer sulme masive ndaj tyre. "Peyman menaxhon shumë operativë, disa për grumbullim informacioni dhe të tjerë për të kryer sulme terroriste. Një nga këta operativë është Alireza Naghashzadeh, një iranian i cili është vetë një ish-anëtar i MEK-ut dhe zotëron një pasaportë austriake. Naghashzadeh u dërgua nga Peymanit për të grumbulluar informacion në Shqipëri gjatë disa vizitave të veçuara, si pjesë e planeve për një sulm që eventualisht u ndalua", tha Veliu.

## DEBIMI I AMBASADORIT IRANIAN

Dhjetorin e vitit të kaluar ambasadori i Iranit në Shqipëri, dhe një tjetër diplomat i ambasadës u dëbuan nga Shqipëria. Ministria e Jashtme njoftoi në atë kohë se "dy diplomatët iranianë u shpallën të padëshiruar, pasi dyshohen të jenë përfshirë në aktivitete që çenojnë sigurinë në vend.

## ÇFARË JANË FORCAT QUDS

"Forcat QUDS janë krahu operacional i IRGC (Islamic Revolutionary Guard Corps - Trupat e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit) që vepron përtej kufijve të Iranit. Forcat QUDS drejtohen nga Qassem SOLEIMANI, i cili është përgjegjës, mes të tjerash, për aktivitetin e Iranit në Jemen, Irak, Siri dhe Liban. Celula terroriste i përkiste, siç u përmend, njësive të operacioneve të jashtme të Forcave QUDS, një njësi operationale e konsideruar si klandestine dhe sekrete, e cila është përgjegjëse për planifikimin dhe zbatimin e aktivitetit terrorist jashtë Iranit. Brenda kësaj njësie, ka një nën njësi që merret ekskluzivisht me organizatat që janë kundër regjimit. Modus Operandi i njësive përfshin menaxhimin nga distanca të forcave të treta (proxy), zakonisht kriminelë dhe anëtarë të mafies me të kaluar të ndryshme, në mënyrë që të mbulohet përfshirja e Iranit në terrorizëm. Duke përdorur këtë Modus Operandi, MOIS (Ministry of Intelligence and Security - Ministria e Inteligjencës dhe Sigurisë) të Iranit ka vrarë të paktën 4 opozitarë të regjimit në Holandë, Gjermani dhe Turqi dhe ka organizuar sulme të pasuksesshme, sikurse ishte sulmi i fundit i mbetur në tentativë kundër konferencës së MEK-ut në Paris, në Qershor 2018", tha kryepolici Veliu.

## STREHIMI I MEK NË SHQIPËRI PREJ VITIT 2014

Nga viti 2014, në koordinim me Kombet e Bashkuara dhe SHBA-ja, Shqipëria ka pritur një numër anëtarësh të MEK-ut, një organizatë që e sheh veten si opozita në mërgim dhe si një alternativë praktike ndaj regjimit iranian dhe për këtë shkak regjimi iranian e sheh atë si kërcënim serioz për mbijetesën e tij. MEK-u është një shënjestër kyçe për forcat e sigurisë iraniane, të cilat tentojnë të sulmojnë anëtarët e organizatës kudo ku ata mund të jetojnë dhe operojnë jashtë Iranit.



Detajet

## FORCAT E QUDS

Operativët iranian të forcave QUDS drejtohen për sulmet në Ballkan nga një kriminel turk, trafikant ndërkombëtar droge, Abdulsalam Turgut, ose një tjetër trafikant droge i lidhur me të, të cilët nga viti 2018, kanë dërguar në Shqipëri operativë të forcave revolucionare iraniane, për sulme kundër muxhahedinëve refugjatë në Shqipëri, MEK.

## IRANIANI I INFILTRUAR

Peyman menaxhon shumë operativë, disa për grumbullim informacioni dhe të tjerë për të kryer sulme terroriste. Një nga këta operativë është Alireza Naghashzadeh, një iranian i cili është vetë një ish-anëtar i MEK-ut dhe zotëron një pasaportë austriake. Naghashzadeh u dërgua nga Peymanit për të grumbulluar informacion në Shqipëri

## HEROINA / TRAFIKANTI TURK KA BASHKËPUNUAR ME HEKURAN HOXHËN E "VOL-VO 4"

# Lidhjet e Abdulsalam Turgut me trafikun e drogës në Shqipëri



Për Abdulsalam Turgut mediat turke kanë pasur raportime të shumta, duke e lidhur edhe me trafikun e drogës në vendin tonë. Mediat turke kanë raportuar se Abdulsalam Turgut ka pasur marrëveshje me disa shtetas shqiptarë, për trafikimin e ngarkesës

së drogës nëpërmjet Shqipërisë në Evropën Perëndimore. Një ndër personat që Abdulsalam Turgut ka bashkëpunuar në aktivitetin e trafikut të drogës, ka qenë edhe Hekuran Hoxha, i arrestuar në shkurt të këtij viti, në kuadër të operacionit "Vol-Vo 4".

Hoxha akuzohet se ngriti laboratorin e drogës në Has, i shkatërruar nga autoritetet gjatë goditjes së grupit "Avdyllaj". Sipas prokurorisë, Hekuran Hoxha kishte organizuar futjen në Shqipëri nga Kosova të 161 pakove me heroinë.

Sasia e drogës, ishte fshehur në një shtëpi, në fshatin e Hasit në Kukës, dhe prej këndej po planifikohej të transportohej në Durrës, ku ishte siguruar një ambient për përpunimin e saj. Prej këndej, sasia e drogës do të trafikohet në Itali.




# Si Gjin Gjoni dhe Arjana Fullani liruan kryetrafikantin turk

## Vendimet skandaloze të gjylatave të Apelit dhe të Lartë që i dhanë lirinë Abdulsalam Turgut që sot kërkohet si terrorist



Vendimi i Gjykatës së Apelit në vitin 2011



Vendimi i Gjykatës së Lartë në vitin 2012

**D**rejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu doli dje për të thënë se ishte zbuluar një celulë terroriste, të cilët në 2018 kishin pasur si qëllim të kryenin akt terrorist ndaj muhaxhedinëve. Një emër i rëndësishëm, për të cilin foli Ardi Veliu është edhe Abdulsalam Turgut, i njohur për autoritet shqiptare, pasi në 2011 është arrestuar në Rinas. Arrestimi në Rinas u bë për llogari të drejtësisë gjermane, pasi akuzohej se kishte trafikuar një sasi prej 1 tonësh heroinë në vitin 2009.

Shtetasi turk, Abdulsalam Turgut, ishte në kërkim në atë kohë edhe nga pesë shtete të Europës. Pas arrestimit të shtetasit turk, prokuroria kishte paraqitur kërkesën në gjykatë për miratimin e arrestit ndaj Abdulsalam Turgutit dhe caktimin e masës së përkohshme të sigurisë "Arrest ne burg" me afat 40 dite për efekt të ekstradimit të tij drejt shtetit gjerman.

Por, në një vendim të Gjykatës së Apelit të kryesuar nga Gjin

Gjoni, u vendos që shtetasi turk të lihet në "arrest shtëpie", duke e detyruar që të qëndrojë në një banesë të marrë me qira nga ai në një pallat tek Kthesa e Kamzës. Pas pak ditësh nga vendimi i Gjykatës së Apelit, është urdhëruar thirrja e Abdulsalam Turgutit në Prokurorinë e Tiranës për të vazhduar me procedurat e ekstradimit për në Gjermani, por që shtetasi turk nuk është gjetur më në adresën që kishte gjykata. Abdulsalam Turguti përfitoi nga ky vendim i Gjykatës së Apelit, me kryesues Gjin Gjoni, për t'u arratisur nga Shqipëria me identitet tjetër.

Edhe pse Prokuroria kishte bërë rekurs në Gjykatën e Lartë për vendimin e Gjykatës së Apelit, kjo e fundit në vitin 2012, në një vendim me Gani Dizdarin kryesues, dhe katër anëtarë Arjana Fullani, Aleksander Muskaj, Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi, gjykuan se masa "arrest shtëpie" për turkun dhënë në 2011 nga Gjykata e Apelit kishte qenë i ligjshëm.

# Artan Hoxha: U paguan 1 mln USD për lirimin e Turgutit nga burgu

## Gazetari investigativ i Report TV zbulon informacionet sekrete: Kryegjyshi Botëror ka marrë disa kërcënime

**G**azetari investigativ Artan Hoxha i ftuar në Report Tv dha detaje në lidhje me celulën terroriste iraniane që u zbulua nga autoritetet shqiptare dhe të huaja, dhe që do të kryenin sulme në vendin tonë. Abdulsalam Turgut është bosi i trafikut ndërkombëtar të heroinës i shpallur në kërkim nga gjykatat gjermane që më 21 nëntor 2009, i akuzuar për trafikimin e 1.6 tonëve heroinë drejt Republikës Federale Gjermane. Njeriu që fshihet pas celulës sekrete iraniane në Shqipëri është arrestuar në shkurt të 2011-es në aeroportin e Rinasit, pas një urdhër arresti ndërkombëtar shpallur nga Interpoli.

"Abdulsalam Turgut ka qenë nën hetim për trafik droge për qëllim ekstradimi drejt Gjermanisë. Historia nis që në vitin 1998. Gjatë një operacioni të policisë turke u godit një grup shqiptarësh që merreshin me biznes. U ra në gjurmët e tyre duke u ndjekur një futbollist me origjinë shqiptare, i ikur herët, që u kap me 30 kg heroinë. U arrit të kapet një episod nga policia turke me 190 kg heroinë që ishte porositur në Turqi dhe do vinte në Shqipëri në rrugë tokësore. Mes personave të kapur ishin Hekuran Hoxha i arrestuar qershor 2019 si i përfshirë në laboratorin e Hasit, në kuadër të operacionit Volvo 4, pjesë e të cilëve është edhe grupi i Avdyllajve. Në vitin 2009 Gjykata në Gjermani ka lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar për Turgut, që akuzohej për trafik të 1 ton heroinë në drejtim të Gjermanisë. Kishte urdhër kërkimi nga autoritetet belge, austriake, italiane. Njëkohë-

sisht ishte arrestuar më herët edhe në Turqi dhe Azerbajxhan dhe ishte në kërkim. Në 2011, në 18 shkurt, Turgut, e shoqëruar nga një 37-vjeçar kurde, ka udhëtuar me avion nga Stambolli në Rinas, dhe është identifikuar me emrin e tij, i është parë statusi dhe menjëherë në listën e të kërkuarve u zbulua që kërkohet nga Gjermania. Është shoqëruar dhe është njoftuar interpol Tirana dhe prokuroria që me kalimin e dosjes në gjykatë, më 21 shkurt të 2011-ës, gjyqtari Kreshnik Omari, e cilësoi të vlefshëm arrestimin dhe e la në masë arresti me burg me qëllim ekstradimit. Në datën 4 mars 2011, në Gjykatën e Apelit avokati i Turgutit, Koli Bele, ka kërkuar ndryshimin e masës së sigurisë me pretendimin se arrestimi nga qenë i paligjshëm dhe se personi ka probleme shëndetësore, dhe nuk ka rrezik të largohet se ka adresë shtëpie, derisa dosja të vinte nga Gjermania. Treshja e Apelit e drejtuar nga gjyqtari Gjin Gjoni, me anëtarë Hysni Demiraj dhe Agron papajani, e ka vlerësuar kërkesën e avokatit të drejtë, nuk ka pranuar kërkesën e prokurorit, dhe i ka dhënë arrest shtëpie. Ai ka qëndruar në



katin e 8 të një pallati të papërfunduar me një kontratë të një personi me emrin Gjin Pjetri. Dhe ata e kanë lënë në arrest shtëpie me adresën e një pallati që ende ishte në ndërtim, tek Kthesa e Kamzës. Për të ndodhur kjo gjë shumë elementë të botës së kriminit, të botës së biznesit, me influencë në politikë, kanë ndërhyrë, dyshohet se është paguar 1 milionë dollarë, dhe sot jemi para faktit që ky shtetas humbi pa nam e nishan. Policia nuk tregoi asnjëherë kujdes për ta mbajtur në mbikëqyrje. Policia shkoi në atë adresë dhe zbuloi që nuk kishte qëndruar kurrë aty, por

në hotel. Me pasaportën e siguruar nga miqtë e tij në Shqipëri ai u arratis. Ky ka qenë bosi i një sërë grupesh shqiptare që janë marrë me trafikun e heroinës. Kur shkohet në Gjykatën e Lartë dhe kërkohet nga prokurori ndryshimi i masës së sigurisë. Dhe një trup gjykues e drejtuar nga Gani Dizdari, me anëtarë, Arjana Fullani, Shkëlzen Selimi, Edmond Islamaj, Alesksander Muskaj, e ka cilësuar të ligjshëm vendim e Apelit edhe pse Turguti ishte arratisur një vit më parë. Në atë kohë prokuroria ka hapur një dosje e cila nuk përfundoi kurrë", tha Hoxha.

**"KRYEGJYSHI BOTËROR KA MARRË DISA KËRCËNIME"**

Në mars 2018, kur një celulë terroriste iraniane tashmë e zbuluar nga autoritetet, do të bënte sulm terrorist, Artan Hoxha i cili ka qenë prezent në Kryegjyshatë, tha se në atë kohë kishte pasur informacione që nuk janë bërë publike deri më tani, edhe për një valë kërcënimesh ndaj kryegjyshit të bektashinjve, Baba Mondit, arsye për të cilën ai aktivitetet u shoqërua me masa të larta të policisë dhe anti-terrorit. "Ngjarja që

ekspozoi më shumë Iranin, ishte festa e Sulltan Nevruzit, kam qenë atë ditë në kryegjyshatën botërore, pasi rrjedh nga zona që e ka atë besim. Garda sapo kishte ardhur, sigurisht policia është prezente sa herë ka aktivitetet. Por kishte edhe agjentë të anti-terrorit, gjë që nuk ishte normale, për më tepër që komuniteti bektashinj nuk ka pasur të tilla probleme. Në pritje të vinte presidenti Ilir Meta, njoftohemi që disa civilë, skuadra e anti-terrorit, kanë ndaluar dy persona. Dy personat i kishim parë nuk i kishim kushtuar rëndësi, ata ishin mes dhjetëra kameramanëve, dhe binin në sy se ishin të moshuar, rreth 60 vjeç. Ata ishin me kamera në lëvizje jo të pozicionuar si të tjerët. I morën dhe i larguan. Njoftojnë zyrtarët e kryegjyshatës se ata që kanë ardhur nga Irani me ftesë tuajën, i kanë shoqëruar në polici. Ata kishin shfrytëzuar ftesat e marra nga Kryegjyshata, dhe këtë festë. Në momentet e para nuk u dhanë shumë detaje nga policia, por u tha që po hetoheshin nga anti-terrori dhe se për ta ishin interesuar shërbimet e vendeve partnere. Ata kanë hyrë legalisht në aeroportin e Rinasit, me ftesë. Para se të ndodhte ngjarja, policia ishte njoftuar për disa kërcënime që i ishin bërë kryegjyshit botëror, nga persona të lidhur me Iranin. Dhe të gjitha këto bënë që të nisnin përgjime ambientale dhe me vëzhgim në terren, të mbajnë në vëzhgim një grup të madh personash, derisa mbas 18 muajsh, nga marsi 2018, deri sot, u bënë publike të dhënat me hetimin. Pritej që shërbimet sekrete të Iranit të përdorin të gjitha mundësitë që do i krijoheshin", tha Artan Hoxha.

# KLJGJ përjashton nga gara për Gjykatën e Lartë Theodhori Sollakun

## Shkak i përjashtimit shkarkimi në vitin 2007 nga posti i Prokurorit të Përgjithshëm

**T**heodhori Sollaku nuk do të vijojë më garën për t'u bërë anëtar i Gjykatës së Lartë. Vendimi është marrë dje nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në dispozitat ligjore që ndalojnë emërimin në Gjykatën e Lartë, nga juristët e spikatur, që janë larguar apo shkarkuar për shkelje ligjore ose disiplinore. Theodhori Sollaku u shkarkua në vitin 2007 nga Prokurori i Përgjithshëm. Sollaku ka afat 5 ditë për të ankimuar vendimin e KLGJ në Apelin Administra-

### AKTUALISHT NË GARË

Jetmira Rragami
Ervin Pupe
Rezarta Melo
Kestrin Katro
Sokol Sadushaj
Ilir Panda
Ardita Alsula

tiv. Aktualisht në garë janë: Jetmira Rragami, Ervin Pupe, Rezarta Melo, Kestrin Katro,

Sokol Sadushaj, Ilir Panda, Ardita Alsula.

Gjithsej ishin 22 kandidatë, KLGJ kualifikoi vetëm 8, por me largimin e Sollakut ngelin 7. Gjykata e Lartë duhet të ketë 19 anëtarë. 16 gjyqtarë karriere dhe 3 nga radhët e juristëve të spikatur.

### MBLEDHJA E KLGJ-SE

Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen e së martës miratoi edhe disa vendime të tjera të rëndësishme. Këshilli pasi u njoh me raportin e përgatitur nga Komisioni

për Vlerësimin e Statusit Individual dhe Karrierën e Inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, miratoi statusin individual për 7 nga 9 inspektor të ish-KLD-së. Dy prej tyre do të trajtohen në mbledhjen pasardhëse.

Këshilli vendosi komandimin e Tereza Lanit (Merkaj) si pedagoge e brendshme, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, Këshilli vendosi deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, të gjyqtarës



Eneida Civici, për shkak të dorëheqjes nga detyra e gjyqtarit, si dhe konfirmoi si ndihmësmagjistrat në

Gjykatën e Lartë të gjyqtarit Florjan Kalaja dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit.

### Egon Velaj

## Dënohet për shpërdorim detyre drejtori i sapoemëruar i burgut Vlorë

Vetëm pak ditë pasi u emërua si drejtues i IEVP Vlorë, Egon Velaj është dënuar me 6 muaj burg nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë. Ai akuzohet për shpërdorim detyre gjatë kohës kur ka ushtruar të detyrën e drejtorit të Aluiznit në Vlorë.

Mësohet se dënimi i Velajt është konvertuar në 6 muaj shërbim prove. Vendimi për Velajn është dhënë nga trupi gjyqësor me prokuror Anton Pali dhe gjyqtare Atalanta Zeqiraj. Egon Velaj kishte vetëm një javë që ishte emëruar nga Ministria e Drejtësisë në krye të burgut të Vlorës.

### Vendimi i gjykatës Korçë

## Protestuan para bashkisë së Maliqit, gjobiten tre militantët e opozitës

Gjykata Shkallës së Parë në Korçë ka shpallur fajtorë, tre militantët të opozitës të cilët protestuan në muajin maj para bashkisë së Maliqit. Të shpallurit fajtorë janë Ernald Muçollari, Ledion Maksuti dhe



Hyxhers Mete të cilët janë dënuar nga gjykata me 90 mijë lek të reja gjobë, për prishje të rendit dhe qetësisë publike e kryer në bashkëpunim. Ata kanë përfituar uljen e 1/3 së dënimit, pasi procesi u zhvillua me gjykim të shkurtuar, çfarë uli masë e gjobës në 60 mijë lek të reja. Këta tre

persona me pankarta në duar 'Rama ik' protestuan për disa ditë në muajin mars, ku së bashku me ish deputetin Klevis Balliu kanë hedhur kapsolle dhe tymuese para Bashkisë së Maliqit.

## ISH-TRUPROJA / AVOKATI PARALAJMËROI DEPONIME KUNDËR BERISHËS

# Izet Haxhia merret në pyetje me orë të zgjatura tek Krimet e Rënda

Avokati paralajmëroi deponime kundër Berishës, Izet Haxhia merret në pyetje me orë të zgjatura shoqëruar për t'u pyetur në lidhje me veprat penale për të cilat akuzohet për vrasjen e ish deputetit Demokrat Azem Hajdari. Burime pranë Prokurorisë për Krime të Rënda konfirmojnë se marrja në pyetje e Haxhisë ka vijuar edhe dje.

Haxhia është pyetur disa herë në pyetje, me orë të zgjatura, nga OPGJ përgjatë javës së fundit. Marrja e shpeshtë e Haxhisë në pyetje vjen pas përplasjeve së dy gjykatave, asaj për Krime të Rënda dhe Penales së Tiranës në lidhje me kompetencat e veprave penale të dosjes "Hajdari". Përfundimisht dosja ka kaluar tek Krimet e Rënda në shtator të këtij viti. Përveç seancave të marrjes në pyetje, Krimet e Rënda nuk mund të

vijojnë me procesin gjyqësor, deri në momentin kur Gjykata Supreme të marrë një vendim përfundimtar në lidhje me gjykatën kompetente.

Ndërkohë avokati i Izet Haxhisë, Idajet Beqiri ditët e fundit ka thënë se klienti i tij, do të fillojë deponimet kundë ish kryeministrit Sali Berisha. Për vrasjen e Azem Hajdarit, Izet Haxhia një nga tre të dënuarit ka fituar të drejtën e rigjyimit dhe procesi për të është hapur nga e para. Një tjetër kërkesë e rrëzuar Haxhisë ishte edhe ajo për përjashtimin e trupës gjyqësore për të cilin avokati thotë se kërkojnë gjykatës me vetting të kaluar. Izet Haxhia i cili u ekstradua nga Turqia pak muaj më parë u dënuar në mungesë me 25 vite për vrasjen e Azem Hajdarit, ndërsa Jahi Sali Mulosmani është i dënu-



ar përjetë për të njëjtin krim. Izet Haxhia ka qenë trupë e Sali Berishës, deri në vitin 1998 gjatë kohës që Berisha ka mbajtur postin e Presidentit të Republikës. Ai është dënuar në mungesë me 25 vjet heqje lirie për vrasjen e ish-deputetit të Partisë Demokratike, Azem Hajdari. Pas vrasjes së

Hajdarit, Haxhia u arratis për të qëndruar afro dy dekada në Turqi nga ku dhe ekstradua më 8 Maj 2018. Pas mbërritjes në Tiranë ai kërkoi rivendosje në afat dhe rigjykim, kërkesa të cilat u pranuan dhe procesi ndaj tij është rihapur më një tjetër trupë gjyqësore në Dhomën Penale të kryeqytetit.

### SHPLLJE ANKANDI

Shoqëria Përmbartimore "616/A" shpk shpall ankandin e parë për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

1-Truall me sip.299.1 m<sup>2</sup> sëbashku me ndërtesën 4- katëshe, me sip157.7m<sup>2</sup> kati përdhe, me sip 175.8m<sup>2</sup> kati i parë dhe i dytë dhe me sip97.8m<sup>2</sup> kati i tretë, me numër pasurie 12/184, vol.34, fq.43, zk.8523, në pronësi të debitorit hipotekues Sabri Dane Mehalla ndodhur në Elbasan, në shumën 21.422.400 (njëzetënjëmilionekatërqindnjëzetëdytmijëkatërqind ) lekë

ANKANDI ZHVILLOHET DITEN E MERKURE NE DT.13.11.2019

Personat e interesuar mund te paraqiten ne adresen Lagjja Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë ; Cel:0682223020, e-mail: shoqeria616a@gmail.com

### SHPLLJE ANKANDI

Shoqëria Përmbartimore "616/A" shpk shpall ankandin e parë për shitjen e pasurisë së paluajtshme:

2-Truall me sip.300m<sup>2</sup> sëbashku me ndërtesën 3- katëshe, me sip 135.5m<sup>2</sup> kati përdhe, me sip 146.7m<sup>2</sup> kati i parë dhe i dytë, numër pasurie 12/188, vol.34, fq.44, zk.8523, në pronësi të debitorit hipotekues Servet Dane Mehalla,ndodhur në Elbasan, në shumën 17.576.800

(shtatëmbëdhjetëmilione pesëqind e shtatëdhjetë gjashtë mijë tetëqind) lekë

ANKANDI ZHVILLOHET DITEN E HENE NE DT.18.11.2019

Personat e interesuar mund te paraqiten ne adresen Lagjja Nr.3, Rruga "Andon Xoxe", Pogradec ose të kontaktojnë ; Cel:0682223020, e-mail: shoqeria616a@gmail.com



# Disa makina me 0 km janë të vjedhura, Nasufi: 15 raste këtë vit

ELIZA GJEDIKU  
TIRANE

**M**akinat me kilometrazh zero që blihen nga shtetasit shqiptarë në kompanitë koncesionare që kanë të drejtën të shesin markat, në disa raste rezultojnë të vjedhura në vende të Bashkimit Evropian. Ky shqetësim është pranuar nga vetë Drejtoria e Transportit Rrugor, ku Astrit Nasufi përgjegjës i regjistrimit të automjeteve sqaron se pavarësisht se INTERPOL e nxjerr makinën të pastër, në të vërtetë mund të rezultojë i vjedhur në një shtet tjetër. Kjo situatë pretendohet se ndodh për shkak të manipulimit të numrit identifikues, shasisë së automjetit. “Kemi edhe një rast tjetër kur mjete është i blerë nga koncesionari në Shqipëri, është blerë me 0 km është blerë në vitin 2009, ka qarkulluar normalisht dhe në vitin 2015 dhe tani rezultojnë pozitiv (i vjedhur

## Pavarësisht se qytetarët i blejnë tek koncesionarët, përgjegjësi i regjistrimit të automjeteve sqaron se s’ka dëmshpërblim kur mjete sekuestrohet

në INTERPOL. Mendoj se kjo ka ndodhur për shkak se është manipuluar numri i shasisë në vendin ku rezultojnë i vjedhur”, thotë Nasufi.

Por çfarë ndodh kur automjeti ndalohet në pikat kufitare pasi në sistem rezultojnë i vjedhur?! Kjo situatë po ndodh në Kakavijë. “Kryesisht ata e sekuestrojnë menjëherë autom-

jetin”, shprehet Nasufi. Por çka është më e keqaj qytetari që humb mjedin nuk merr asnjë kompensim financiar nga kompania koncesionare. “Nuk mban përgjegjësi askush për këtë situatë, as koncesionari që e ka shitur”, sqaron Nasufi.

Përgjegjësi i regjistrimit të automjeteve pohon se vetëm këtë

vit janë identifikuar rreth 15 raste ku makinat e reja të blera nga shqiptarët, nuk janë zbuluar në pikat tona kufitare si të vjedhura, dhe janë bllokuar nga autoritetet e huaja. “Shifrat në total të mjeteve që dalin të vjedhura të deklaruar në INTERPOL dhe që kërkojnë shërbim regjistrimi për herë të parë është 78

automjete për vitin 2018, dhe 116 për 9 muajt e vitit 2019. Ndërsa rastet kur mjete është i rregullt në dokumentacion është verifikuar në INTERPOL, dhe ka dalë i rregullt, pra nuk ka dalë pozitiv (i vjedhur), por që rezultojnë i vjedhur nuk janë më shumë se 10-15 raste”, tha Nasufi.

Nasufi thotë se është domosdoshmëri që sistemi i INTERPOL-it të jetë aktiv në pikat doganore përpara se të zhdoganimi i makinave të importuara. “Sot dogana bën procedurën e zhdoganimit pa bërë identifikimin më përpara në INTERPOL. Nëse ai mjet është deklaruar i vjedhur (në INTERPOL) në një farë mënyre e legalizon pra në doganë duhet të ishte detyrimisht INTERPOLI përpara se të ofrohet shërbimi i zhdoganimit”, u shpreh për Report TV Nasufi.

Kjo situatë bie në kurriz të qytetarëve shqiptarë të cilët blejnë makinat e reja në vlera që arrijnë mbi 70 mijë euro, por që nuk mund të marrin pas asnjë lekë nëse makina me zero kilometra rezultojnë e vjedhur!

## PAMJET

# Jaku do ndërtohen portet e jahteve në Sarandë dhe Kepin e Rodonit

**R**eport TV ka sjell pamje nga vendi ku do të ndërtohet porti i jahteve në Sarandë. Koncesion përmes partneritetit Publik-Privat, i fituar nga Biznesmenët Shefqet Kastrati dhe Artan Dulaku për një periudhë 35-vjeçare. Vlera e investimit për portin turistik “Marina Limion” kalon 1.3 miliardë lekë pa TVSH. Aktualisht vendi ku do të ndërtohet porti siç duket nga pamjet është i pamirëmbajtur, pavarësisht se është vijë bregdetare me një pamje piktoreske aty ndodhen shumë pak anije kryesisht të vjetra dhe një numër i reduktuar jahtesh. Këto zona janë lënë pa ndërtim pasi kane qene nen administrimin e Ministrisë se Mbrojtjes. Paraprakisht vetëm janë shpallur fituesit e koncesionit, që është bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive



“Kastrati” sh.a dhe “Edil – AL – IT” sh.p.k, por nuk është përcaktuar afati kohor se kur do të jetë në përdorim ky port turistik dhe shërbimesh.

Ndërkohë porti tjetër që do të ndërtohet 7 km larg Kepit të Rodonit, “Marina Rodon” është një vend tërësisht i braktisur, dhe në të

ndodhen vetëm disa varka të vogla dhe të vjetra. Fitues të tenderit në një garë pa konkurrentë, u shpall bashkimi i operatorëve “Praslin Investment” sh.p.k dhe “R&T” sh.p.k, me aksionerë Roland Ziun dhe Renis Terhana, me fond prej 883 milionë lekë pa TVSH për 35 vite. Ky port është parashikuar të ndërtohet pikërisht në këtë zonë që paraqitet në pamje dhe do të ketë thellësi të favorshme për strehimin e mjeteve lundruese me zhytje deri 5,5 metra.

Vendi i përzgjedhur kërkon ndërtimin e “Marina Rodon” nuk prek pjesën turistike por edhe fatet e Kishës Shën Ndout, që po administrohet nga Kisha Françeskane, dhe ndodhet disa metra larg bregdetit, në brendësi të territorit Kepit të Rodonit.



## SHPALLJE ANKANDI II



**Zyra permbarimore, me permbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dyte për pasurine:**

1- “Are”, me sipërfaqe totale 1.080.00 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Bathore, Tirane, në Zonën Kadastrale: 3992, Numri i Pasurisë: 7/15, Vol.1, Faqe 69, ne pronesi te Beqir Sulejman Cali. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 840.000 (teteqind e dyzet mije) . LEKË

Ankandi i dyte per pasurine e mesiperme zhvillohet me date 18.11.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës se permbaruese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr.“Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 04 222 9114 .

# GJERGJ FISHTA

## RILINDJA SHQIPTARE DHE POEMA "LAHUTA E MALCÍS"

**"Lahuta e Malcís" e át Gjergj Fishtës më ballkanikja e Rilindjes Shqiptare, e fundmja kultivimit të një tipologjie të veçantë gjinore në Ballkan: poemës epiko-historike. Këngët e shkruara drejtpërdrejt nën vrullin e ngjarjeve historike**

**BLERINA SUTA**  
TIRANE

Studiuesi rumun Mircea Popescu, në hyrjen e një antologjie të letërsive të Evropës Juglindore, shprehet për vështirësinë e formulimit të një koncepti të 'përbashkët' për letërsinë e popujve ballkanikë (ose të Ballkanisë, siç e quan ai gadishullin në tërësinë e tij). Mund të flitet për një "qytetërim të përbashkët" dhe për një "njësi të përbashkët shpirtërore kulturore". Sidomos në "përjashtimet", shprehet ai, popujt ballkanikë shfaqen të gjithë "me një fat pak a shumë të njëjtë". Nëse do ta përdornim konceptin e 'letërsisë ballkanike' (koncept përgjithësues dhe në fund të fundit 'ideal', po aq sa termi goethean Weltliteratur apo termi 'letërsi evropiane') tiparet e përbashkëta të kësaj letërsie, nga këndvështrimi historiko-letërsor, do të mund t'i gjenim sidomos në periudhën para krijimit të shteteve-kombe. Romantizmi në kuptimin e "shpirtit të epokës", do të shfaqet të njëjtat simptoma të lëvizjes analoge evropiane, të gjitha vendet ballkanike, ndonëse dy breza më vonë siç do të shprehet Çabej. Por ndërkohë ai karakterizohet nga tipare vetëm ballkanike, të cilat i kanë rrënjët e tyre në atë "përzjerje racash" apo në ato tipare "ndërnjerëzore" baritore, të cilat janë jo vetëm faktor ngjashmërie, por dhe vonese për popujt ballkanikë.

Siç saktëson Çabej, qëndrimet e popullive autoktone dhe atyre të ardhura qenë të ndryshme; ato realizuan një përzjerje që mban vullat e fazave të ndryshme të historisë së Ballkanit. "Sllavët (...) qenë një popullsi bujqish luftëtarë; prandaj sjellja e tyre ndaj popullsisë greke e romake të gadishullit në fushën kulturore e religjioze qe nevojshisht më tepër marrëse"; (...) shqiptari, "pas zakonit të lashtë u tërhoq në malësi, për të rënë prapë, pas një kohe prej disa shekujsh, me fuqi të përtëritura në lugina, të cilat i shtinë prapë në dorë". Pikërisht, në këtë kontekst, Çabej

flitet për "simbiozë shqiptaro-sllave", e cila zgjat gjatë gjithë mesjetës dhe "mbërrin në mbarim të kësaj periode në këtë përfundim: shumë sllavë u shqiptarizuan në Shqipëri, shumë shqiptarë u sllavizuan, sidomos në viset periferike të Veriut". Këto rrethana socio-ekonomike kushtëzuan dhe tiparet kulturore letrare që karakterizohen, përveç tipareve të ushqyera prej kësaj simbioze, edhe nga një 'vonesë' përkundrejt fenomeneve

mantizmit shqiptar bën pjesë në një paradigme ballkanike të romantizmit, e cila, përveç shmangies nga modeli evropianoperëndimor, karakterizohet nga elemente të tjera të përbashkëta apo "konstante", që e bashkojnë me vendet e tjera të

### BALLKANIT, SIDOMOS ME SLLAVËT E JUGUT.

Në kapërcyellin mes shekujve XIX dhe XX, Shqipëria do të bëhej bartëse e një fermentimi dhe shtresëzimi fenomenesh politike, kulturore dhe letrare, të cilat nuk do të shënonin një etapë të zhvillimit të saj organik kulturor-letërsor si në Evropën Perëndimore, por një 'kalesë' që do të mund të konsiderohej si fillim i ndërgjegjësimit për vetëqenësinë kulturore nacionale dhe i përvojës së kultivimit artistikoletrar. Do të ishte mjaft e rëndësishme të evidentohet (si në rastin e shqiptarëve, ashtu dhe të sllavëve të Jugut) se sa këto shfaqje të para të plota të letërsisë artistike do t'i detyrohen letërsisë pararendëse me natyrë fetare dhe se si do të raportohen ato me traditën evropiane klasike dhe moderne. Romantizmi dhe iluminizmi në Ballkan nuk do të lindnin si kundërshtitë të njëra-tjetrës, por do të gërshetoheshin në shërbim të lëvizjes kulturore për rilindjen e kulturës, gjuhës dhe ndërgjegjes kombëtare. Me gjithë mungesën e antonimisë iluminizëm-romantizëm dhe të debatit filozofik në përgjithësi, do të ishte e rëndësishme të shihej se sa vend do të zinte në veprat e romantikëve ballkanikë kulti iluminist i arsyes, i njeriut dhe popullit. Feja dhe metafizika e kombit, si tipare të trashëguara nga romantizmi gjerman, duhet parë në masën se sa kushtëzuan secilin prej vendeve të Ballkanit. Duhet parë gjithashtu se sa misticizmi, metafizika dhe feja (si tipare themelore të romantizmit idealist gjerman) të pranishme tek autorët ballkanikë, do të kushtëzojnë krijimin e letërsive kombëtare. Nën ndikimin e teorive dhe të praktikës folklorike të gjermanit Herder dhe më pas të italianëve Tommaso dhe Cantù, kultura shqiptare (arbëreshe dhe ajo e autorëve shqiptarë), si dhe ajo e sllavëve të Jugut, do të shënonin një sërë arritjesh në mbledhjen dhe përhapjen e pasurisë gojore folklorike. Vepra e Kamardës, De Radës, Kristoforidhit, Mitkos, do të luanin po atë rol për kulturën shqiptare që e kishin luajtur përfaqësuesit e lëvizjes rilindëse, (Preporodni pokret tek sllavët e Jugut): serbët Dositej Obradović (1744-1811) dhe Vuk Karadžić (1787 - 1864); kroatët Ljudevit Gaj

(1809-1872) dhe Janko Drašković dhe sloveni Stanko Vraz (1810-1851). Në këtë kontekst, letërsia gojore dhe 'nyjat' e përbashkëta për nga lënda mitologjike dhe ajo etno-kulturore, bëhen bazë për kultivimin e letërsisë së romantike.

Intelektualët shqiptarë dhe sllavët e Jugut karakterizoheshin nga interesi i përbashkët për 'kodifikimin' e një gjuhe të vërtetë letrare, si elementi parësor i kombit të ri që po lindte. Shpesh, në të dyja kahet, ky kodifikim është realizuar nga njerëz që për arsye të ndryshme janë detyruar të largohen në ekzil. Qëndrimi i autorëve romantikë ndaj folklorit është i lidhur ngushtë me raportin e tyre me 'atdheun e ngushtë', me truallin e fisit, siç do të shprehet Çabej. Në kontekstin e këtyre 'qarqeve kulturore' rajonale, në fazën para krijimit të shtetit nacional, mund të thuhet se pikat e përbashkëta do të gjenden sidomos tek ata autorë që u bazuan në traditën folklorike.

Për secilin nga këta autorë, substanca e përbashkët e përmbajtjes popullore dallon në realizimin konkret të secilit, sipas veçorive përkatëse të secilit popull të bartura në poetikat e tyre ideologjike.

Pra, metafizika e 'kombit' do të orientojë edhe kodifikimet e ligjërimit letrar të bazuar në të folurën popullore. Krijimi i 'mitopoesis'-it të kombit do të kristalizonte, nën formën nacionalcentriste të mendimeve, edhe substancën gjuhësore të ligjërimit poetik. Autorët më të mëdhenj shqiptarë të shekujve XIX dhe XX u munduan të krijojnë një epos kombëtar: De Rada me poemën e tij Skënderbeu i pafan (1872); N. Frashëri me poemën Istori e Skënderbeut (1898) dhe arbëreshi Zef Schiro, me poemën Te dheu i huaj (1942) dhe Kthimi. Pjesa më e madhe e kritikës bashkohet me mendimin se eposi kombëtar i shqiptarëve është poema Lahuta e Malcís. Analizimi i kësaj vepre në kontekst jo vetëm kombëtar, por dhe mbinacional, mundëson përjasjen, nëpërmjet gjinisë epike, të poetikës 'romantike' shqiptare me atë të sllavëve të Jugut.

### "LAHUTA E MALCÍS" E AT GJERGJ FISHTËS

1. Objekti i kërkimit/ Përvijimi i tipareve të romantizmit shqiptar në profilin e një paradigme ballkanike të romantizmit (me konstantet dhe kundërshtitë) do të bëhej i mundur nëse përjasja dhe raportet do të zhvilloheshin në nyjat e përbashkëta dhe degëzimet e veprave më të rëndësishme të përfaqësuesve të romantizmit ballkanik. Objekt i këtij studimi është vepra e At Gj. Fishtës,



Blerina Suta

kulturore-letërsore të Evropës, dëshmi e ritmit të ngadalit social të këtyre vendeve pas shtrirjes së pushtimit turk në Ballkan.

Në mënyrë të ngjashme me humanizmin, edhe lëvizja e ringjalljes kombëtare apo Rilindja vërteton zhvendosjen diakronike, në kontekste kulturore "të ndryshme" nga ato evropianoperëndimore, të disa kategorive dhe koncepteve që përdoren për të individualizuar apo për të përcaktuar "fenomene të ngjashme nga pikëpamja tipologjike, por të ndryshme nga pikëpamja historike", siç specifikon Sante Gracioti kur analizon humanizmin në vendet sllave. Ndonëse kritika e shihet të vështirë të përcaktojë se sa nga tiparet e romantizmit shqiptar i detyrohen 'importimit' nga letërsia romantike evropiane dhe sa karakterit të saj 'autokton', mund të thuhet se forma historikisht e veçantë e ro-

Gjergj Fishta

Lahuta e malcís, 10 si vepra më ballkanike e Rilindjes shqiptare dhe e fundmja e kultivimit të një tipologjie të veçantë gjinore në Ballkan: poemës epiko-historike. Gjithashtu objekti në fjalë shënon fundin e Rilindjes në letërsinë shqipe; kjo veprë kufizohet me modernizmin pa shënuar ndonjë "fat letrar" apo pa krijuar shkollë letrare, por duke shënuar një nga veprat me 'fat' më të çuditshëm për sa i përket "horizontit të pritjes" në fazën e krijimit nga 1905 deri në 1937, gjatë komunizmit, kur u ndalua nga regjimi i E. Hoxhës, dhe përgjatë viteve paskomuniste, kur rehabilitimi u orientua më shumë në ekzaltimin e një veprë padrejtësisht të varrosur për pesë dekada.

2. Përshkrimi i veprës

2.1. Struktura

Poema përbëhet prej 15 613 vargjeve tetërokëshe (me theks kryesisht mbi rrokjen e 3-të dhe të 7-të, siç e do tradita shiptare e vargut), të organizuara në 30 këngë. Pjesa më e madhe e këngëve do të botohej veçmas, në variante të përpunuara shpesh prej autorit, deri në formën përfundimtare. Me gjithë ripunimet për t'i siguruar homogenitetin dhe vazhdimësinë "bllaqeve narrative" të konceptuara fillimisht si të veçanta, struktura përfundimtare e poemës nuk paraqet një strukturë të njësuar. Dy blejt e parë të Lahutës të titulluar Lahuta e malcís. Këngë popullore, Blee i pare (1905?), dhe Lahuta e malcís. Blee i dyte (1906)11 përbëjnë gjithsej tetë këngë të veprës përfundimtare të botuar më 1937 dhe gjenden përkatësisht: bleu



i parë, që këndon episodin e Urës së Rrzhanicës, në këngët 12, 13, 14 dhe 15 të Lahutës; 12 dhe i dyti, i cili këndon episodin e Vraninës, në këngët 2, 3, 4, 5 të Lahutës. Kritiku Arshi Pipa, duke marrë në konsideratë diferencën kohore mes botimit të blejve të parë dhe redaktimit ërfundimtar të veprës, pohon se dëshira e Fishtës për ta mbaruar veprën dhe për të marrë të "shumëdëshiruarin" titull "poet kombëtar" e kanë detyruar atë "të veshë uniformën e kryezytarit të nacionalizmit" në një kohë kur epika ishte zhdukur nga qarkullimi. Sipas Pipës, këngët e shkruara më vonë, "kur muzat poetike nuk i përgjigjen thirrjeve të poetit", flasin se rikthimi (në vitet '30) i një veprë, koha e së cilës kishte kaluar, e kishte dëmtuar atë në stil. Kështu këngët e shkruara drejtpërdrejt nën vullmin e ngjarjeve historike (Ura e Rrzhanitsee dhe Vranina) dallojnë nga këngët që e reduktojnë veprën në një "ushtrim të pastër retorik" të karakterizuar nga stili "i fryrë".<sup>14</sup> Duke përmendur këngët e krijuara më vonë, me numrin përkatës të vargjeve, Pipa arrin ta quajë këtë pjesë një "shitesë prolixë" të njave fillestare, si dhe Lahutën në përgjithësi një veper që "duke filluar si një epikë e vërtetë që ngre lart vetitë e banorëve gegë të maleve, përfundon në një prolix grotesk, ku historia dhe mitologjia mbishtrosohen, folklori përdoret keq dhe tradita kombëtare shndërrohet në parrokiale".

#### PËRMBAJTJA

Në vija të përgjithshme kritika ka

evidentuar tri rrafshë kohore të Lahutës, që i përkohjnë tri nyjave kryesore tematike (apo kohës "së rrëfyer"), rreth së cilave autori ndërton episodet: a) lufta e familjeve të Hotit dhe Grudës kundër malazezëve në 1856-58 dhe ngjarjet e Betejës së Vraninës. (Kk. I-V); b) ngjarjet rreth Kongresit të Berlinit, 1878, dhe krijimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, deri më 1880 (Kk. VI-XXV); c) Revolucioni Xhonturk dhe luftërat ballkanike 1912-1913, kur Konferenca e Ambasadorëve në Londër ndan sërish trojet shqiptare për të kënaqur kërkesat e fqinjëve sllavë dhe grekë (Kk. XXV-XXX). Një përshkrim të detajuar të rrafshëve historike të poemës e ka bërë një nga studiuesit historikë të Lahutës, M. Lambertz.

Botimi i tretë (2005) i Lahutës... në parathënien e p. Z. Pllumbit përmban një ndarje më të detajuar të këngëve të veprës, falë interpretimit më të saktë të 'historisë' së Lahutës. Z. Pllumbi specifikon vitin 1834 si skajin më të hershëm kohor të historisë së rrëfyer të poemës (informacion i dhënë në 270 vargjet hyrëse (protasis) të Lahutës), kohë kur ishte ende gjallë në Mal të Zi Petar Njegosi i Dytë. P. Z. Pllumi përmend, gjithashtu, në mënyrë të detajuar rrafshet historike të cilave u korrespondojnë këngët, duke theksuar dhe dallimin mes së vërtetës "historike" të episodeve dhe së vërtetës "ideale", artistike të autorit. Ai dallon gjashtë "cikle" të lidhura nga katër këngë të ndërmjetme, që përbëjnë urat lidhëse të skemës së poemës: 1. cikli I: k. I-V (Beteja e Vraninës); k.

VI, Dervish Pasha, që përfshin 20-30 vite betejash turko-malazeze);/2. cikli II: kk. VII-X (Lidhja e Prizrendit) (me k. XI, Lugati, si

ndërlidhëse);/3. cikli III: kk. XII-XV (në Urën e Rrzhanicës); (me k. XV, Kulshedra si ndërlidhëse);/4. cikli IV: kk. XVII-XXI (në Urën e Sutjeskës); (me k. XXI, Ndërmjetësia si ndërlidhëse);/5. cikli V: kk. XXII-XXV (këngët për Tringën);/ (me k. XXVI, Koha e re si ndërlidhëse);/6. cikli VI: kk. XXVII-XXX (cikli për Dedë Gjo Lulin dhe revoltën e malësorëve të 1911ës dhe mbaron me traktatin e Londrës, 1913).

Sidomos këngët e botuara në fillim paraqesin ndryshime, shtesa në strukturën përfundimtare të poemës, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë mes episodeve që i përkasin të njëjtit bllok narrativ. Në çdo këngë, pra, mund të vihet re një 'hapësirë' e pavarur dramatike, e cila riformulohet prej autorit në continuum-in e një syzheti më të gjerë narrativ, sipas një skeme më të gjerë të ndarjes historiko-kohore.

3. Problemi i botimit të tekstit: mungesa e një botimi kritik Fishta është paraqitur në shtyp me një "kangë popullore" qysh më 190020, në revistën "Albania" të Faik Konicës me titull N'emën t'shqiptarve ci dun vennin. Bleu i parë, Te ura e Rxhanitses (1904), përfshin 5 këngë me 1109 vargje; bleu i dytë, Vranina, përbëhet nga 4 këngë me një numër prej 1308 vargjeshe, ndërsa teksti përfundimtar do të botohet më 28 nëntor 1937.

Mungon një studim i hollësishëm i kalimit të varianteve fillestare në strukturën e veprës të botimit të '37. Botimi kritik i veprës do të bënte të mundur përfshirjen e të gjitha modifikimeve dhe shtesave nga 1904 në 1937. Dimë se autori derinë çastin e fundit ka kryer modifikime dhe korrigjime të shumta, si për të eliminuar gabimet, ashtu dhe për të përsosur tekstin. At Daniel Gjeçaj që ka përgatitur botimin e dytë (postuma) të poemës (Romë, 1958), në "Parathanjen" e veprës saktëson: "Jam mundue të rrejë më ndergjegje e perpikmenë drejtshkrimin e botimit të parë. M'asht dridhë dora edhe atherë kur m'u desht të shëndroji ndonji send të vogël a por të permisoj ndonji gabim të rshitun në botimin definitiv të vitit 1937. Mëndihmoiedhe më dha zemër në këtë rasë kujtimi se vetë Fishta, në dit të mbrame të jetës, ankohej për gabime shtypi të Lahutës dhe pohonte se në të parin ribotim do të bante ndonji permirsim edhe per kah shtrisija". Ndryshimet ortografike të bëra nga Gjeçaj shoqërohen dhe me disa rri:

1. përmasat e germës;/2. numërimi i vargjeve;/3. përmbledhja e këngëve;/4. shënimet shpjeguese në tekst. Glosari në fund të tekstit, ashtu si glosari i B. Demës që Z. Pllumbi e ka vendosur në fund të botimit të tretë (2005), është mjaft i rëndësishëm për studimin e veprës nga studentët e mësuar me gjuhën letrare. Falë mjeteve që ofron botimi i sipërcituar i Gjeçajt, do të jetë pikërisht botimi i dytë (1958, Romë) i përgatitur prej tij objekt i studimit në fjalë.

#### CILËSIMI I LAHUTËS SI "POEMË KOMBËTARE"

Mendimet mbi Lahutën do të ndërtohen në funksion të idesë kombëtare që kjo veper ka rrezatuar në faza të ndryshme të jetës së kombit: në fazën kur u shkrua dhe u realizua botimi përfundimtar i veprës - fazë kur shteti i parë shqiptar kishte mbushur një çerek shekulli - Lahuta plotësohet si veper nën titullin "epope kombëtare"; në fazën e komunizmit - kur vepra u ndalua pikërisht për shkak të vlerës nacionaliste antisllave - u mësua përmendsh dhe u transmetua nga një brez malësorësh tek tjetri; në fazën aktuale - ndoshta për të njëjtat shkaqe ideologjike që e ndaluan përgjatë komunizmit - ky epos po merr gjithnjë e më shumë ngarkesë nacionale, duke dëmtuar në mënyrë arbitrare vlerat e vërteta të shenjës letrare.

#### 'PRITJA' E LAHUTËS NË VITET E BOTIMIT TË SAJ

Fati i padiskutueshëm i Lahutës gjatë viteve të botimit, por dhe më vonë, diktohet prej gjykimit të saj si veper që paraqet vlerat "etnografike"

në studimin e kësaj veprë rrjedh nga përcaktimi i saj si "poemë kombëtare" qysh në ato vite. Ky titull i detyrohet pikë së pari pozicionit subjektiv të autorit, i cili megjithëse kishte arritur tashmë në vitet '30, këmbëngulte t'i jepte një epos popullit të tij, pasi, siç shprehej vetë, "tash qi është bā Shqypnija, duen perbā Shqyptarët". Madje, Fishta krenohet se kish qenë pikërisht ai, i vetmi poet katolik evropian, që kishte krijuar një poemë kombëtare, në të cilën edhe myslimanët e shihnin veten të pasqyruar në imazhin e një identiteti të përbashkët shqiptar. Funkcioni i Lahutës si poemë kombëtare u njoh jo vetëm nga studiuesit, bashkëkohës të autorit, por dhe nga njerëz jashtë kulturës shqiptare, që e konsiderojnë këtë poemë si "punimin më të madh dhe më të përsosur në fushë të letërsisë shqipe", siç do të quhet në një letër të ministrit të urdhratit francezkan.

Qysh në vitin 1925, kohë kur nuk kishte përfunduar redaktimi përfundimtar i veprës, Cordignano-ja në Epopeja komtare e popullit shqiptar, e konsideron Fishtën si "poet epik",

"perm të gjith poet e

komit të vet". Në shpjegimin e këtij përcaktimi autori dëshmon se ka parasysh tipare që kanë të bëjnë me çështje jashtëletrare: "Kur na thom poem, kemi para ssh kallximin epik i njaj ndodhis historike meshum randsi e qi ka pasë efektet e veta të lumnueshme në zhvillim komtar të nji populli". Kështu dhe L. Poradeci në 1943 pohon: ashtu si "Naim Frashëri, një bektashi shqiptar, puth Krishtin në emër të kombit, [...] diplomati Pashko Vasa, një katolik shqiptar, sodet vetëveten për të gjetur Mendimin e Kombit; [...] kryengritësi Mihal Grameno, një ortodoks shqiptar, këndon vjershetorët dhe dëgjon veteranët, mëson mendimin e Kombit; [...] edhe prifti Gjergj Fishta, Vazhdimtar në udhën e Kombit, Frymëtar i Fjalës, solli Dhuratën e vet në Adhurimtoren e Atdheut-Shpirt, Mendim i Parathënësve të Shqipes".

'Pritja' që iu bë poemës në botimin e saj si veper, që, "duke hetuar në thellësitë shpirtërore

të popullit dhe duke kërkuar të deshifrojë veçantinë dhe brumin e tij etnik", kërkonte të "krijonte vlera shqiptare për t'i shkrië në sintesa harmonike me shpirtin përëndimor", pati të tillë sukses sa studentët shqiptarë në Gjermani e gjetën më shumë veten tek kjo poemë, sesa tek përmbledhja Anzat e Parnasit. Censura gjatë regjimit komunist E njëjta etiketë, "epos kombëtar", për më shumë shkruar nga një klerik, që një nga shkaqet e 'fshirjes' së saj nga Historia e letërsisë shqiptare nën regjimin komunist. Censurimi rrodhi si pasojë e idilit shqiptaro-sllav, imazhi i të cilit turbullohej nga nacionalizmi antisllav i Fishtës. Për të njëjtën arsye, po për shkaqe diametralisht të kundërta, albanologët antikomunistë në ekzil ngritën lart veprën, jo aq për vlerat e saj letrare, sesa për ato elemente që ndihmonin gjallërimin e ndërgjegjes së identitetit kulturor kombëtar.

Shënimi: Pjesë e shkëputur nga studimi i Blerina Sutes "Eposi i At Gjergj Fishtës". Titujt dhe mesitujt janë redaksionalë. Përgatiti për botim: Dhurata Hamzai

### Blerina Suta

## EPOSI I AT GJERGJ FISHTËS përballë eposeve të shkrimtarëve romantikë sllavojugorë



Onufri  
BOTIME


të popullit shqiptar, fisin në fazën e fillësës së tij historike. Pjesa më e madhe e studiuesve janë ndalur pikërisht në këto vlera. Përveçse është një veper arti, thotë E. Çabej, kjo veper përbën dhe një dokument etnografik të jetës shqiptare. Këtij qëllimi i përshtatet dhe forma e jashtme e poemës, stili burror dhe i fortë, gjuha therëse dhe larg çdo ëmbëlsie të tepuar: "Grumbullin epik të poemit, thoshte Çabej, e përbëjnë dinariket e vrazhdë të këtij vendi, nga mesi i të cilëve dalin dalëngadalë trimat kryesorë. Themelin shoqëror e formon fisi me jetën e përditshme të tij, siç na shfaqet te Kanuni i Lek Dukagjinit mbledhur prej të ndjerit Atë Shtjefën Gjeçovit".<sup>23</sup> Për G. Valentinin vlera e poemës "është e barabartë me çdo dokument zyrtar apo me më të mirin studim shkencor për jetën dhe traditën filozofike, sociale, juridike, politike të popullit shqiptar; ndoshta dhe më mirë, pasi nga fillesa fish-tiane përftohet hermeneutika më e mirë e dokumenteve dhe sugjestionit estetiko-moral, që u jep jetë dhe jehonë traditave." Problemi i madh

SOPRANOJA / "NËSE JEMI HUMANË, NUK ZHDUKEMI SI KOMB"

# Ermonela Jaho koncert bamirësie për kancerin në gji

Në një koncert ndryshe, Nku arti ishte kryefjala për një kauzë bamirësie. Kësaj here për të mbështetur gratë e prekura nga kanceri i gjirit mbrëmjen e djeshme në Qendrën Kulturorë Ortodokse artistet Ermonela Jaho, Vikena Kamenica, Enada Hoxha dhe Paola Jaho performuan në një koncert. Në performancat e tyre artistet sollën shpirtin e një gruaje të emfatuar deri në pafundësi. Në veprat e kompozitorëve të shquar botërorë katër artistet dhanë shpirtin e tyre në artit që sollën, e kështu duke iu bashkuar të gjitha së bashku nën shoqërimin e një fluturë që fluturon.

Ermonela Jaho në daljen e saj në skenë, e quajti të veçantë këtë koncert, jo sepse janë



vetëm katër artiste në skenë, por edhe sepse shumë zemrave janë bërë bashkë për të dhënë një mesazh të fortë me artin e tyre: "Të jemi shoqëri më humane, vetëm kështu kombi ynë nuk do të zhduket asnjëherë!"

Repertori i bazuar mbi heroina, siç është Madame Butterfly, bëri që këngëtarja lirike, Ermonela Jaho, nën shoqërimin e pianisteve klasike, por edhe të fluturës, që u jetësua nga Enada Hoxha, duke qenë gjatë gjithë kohës

në skenë, të vendoset një gurë i fortë në këtë mur të vështirë.

Sopranoja Ermonela Jaho, kësaj here ambasadore e YWCA (shoqatë jofitimprurëse) zbriti nga skenat ndërkombëtare, për të përjetuar emocionet e mëdha para publikut shqiptar,

por kësaj here, jo vetëm si artiste, por edhe si grua, mikeshë edhe shoqe. Me të ardhurat e koncertit do të ngrihet fond

bamirësie, që do të ketë në qendër konsultat psikosociale falas me gratë që janë të prekura nga kanceri në gji.

## Tollovia



NGA EDISON YPI

historike. Nuk kanë ndejtur atje ku i ka caktuar Zoti paqësor. Kanë ardhur këtu ku i ka urdhëruar Djalli revolucionar. Kanë zënë hapësirën e atyre që kanë bërë shkolla dhe janë të talentuar dhe stërmundojnë kot së koti veten dhe publikun duke bërë shkrime të palexueshme.

Në fis dhe më gjërë kam djem e vajza, tigra e tigresha, luanë e luane-sha, të shëndetshëm, të fuqishëm, të edukuar, të qytetëruar, mbaruar shkolla. U them un i squti këtyre budallejve; Ju me mospjesëmarrjen tuaj, me qëndrimin tuaj mënjane, u krijoni hapësirë horrave. Jepini një dorë komunitetit, shtetit Kombit. Futuni, kridhuni, parteciponi (nuk u them "merrni pjesë" se tingëllon si "vidhni"). Më thonë ata mua; Si i kanë katandisur institucionet këta që i kanë zaptuar, na vjen ndoht të merremi me punët e shtetit e të Kombit. Kemi frikë se para se të bëjmë ne ndonjë punë, sapo të bljmë hapin e parë, të paaftët që na kanë zënë vendin me anë të ca metodave gjeniale që i dinë vetëm ata, na groposin, na varrosin.

Shoh në televizor ca nipër e gjyshër me shall të kuq në qafë në një sallë ku me brohorima të cjertra dhe duartrokitje si trokitje çizmesh parade ushtarake evokojnë heroizmat e një lufte inekzistente. Janë bijtë dhe etërit e shajve në qafë që varën me litar në qafë shqiptarët më të mirë. Kanë të drejtë. Mund të vazhdojnë të bëjnë çfarë të duan sa kohë ata të litarit në qafë nuk ngrihen nga varri tua shtërëngojnë shallin e kuq në qafë këtyre të qokave sa tu dalin kokërdhokët e syve nga vendi dhe shkuma nga goja, tu varet koka dhe të venë në hale të gomarit.

Rasti e solli të njihja një ditë një nëpunëse. Sa e keqe ajo nëpunësja. I kishte zënë vendin një kurve që mezi nxjerr ndonjë lek me djersën e ballit në hotelet me orë.

Nuk mbarova dot punë paradite në një zyrë. U merrza shumë. Më thanë se kishte ndodhur një rrokadë; Vendin e punës së atij që ngrihet



herët në mëngjez e kishte zënë një tjetër të cilit gjumi i dilte në mesditë.

Italia, Franca, dhe plot vende të tjera europiane ndaj të cilëve ne jemi miza, nuk bëjnë asnjë zhurmë; se kanë bërë luftë, kanë bërë heroizma, kanë pasur dëshmorë. Thonë thjesht dhe me modesti se kanë bërë "rezistencë". Harbutët tanë të sotëm e të mëparshëm bërtasin e ulurasin se jo vetëm kemi bërë luftë, por lufta e tyre filmike-propagandistike ka qenë dhe nacionale, madje dhe çlirimtare. Thuaj pastaj se e ka fajin Holanda, Danimarka, Franca, Macroni, për ca telashe që po kemi.

Njoh prej vitesh njërin që ka shpallur se është shkencëtar i Gjuhës Shqipe. Shpërndan gjithë kohën meselera banale të sajua ose gjysëm të vërteta. Ndoshta mund të kenë qenë të mrekullueshme për skeçe estradash të kohës së qepës gallatat e tia, por s'kanë asgjë të përbashkët me Shqipen e aq më pak me shkencën për të cilat paguhet nga taksat llafazani gjoja studjues që pengon talentet e reja.

Kam njohje me një filozof që nuk del kurrë në asnjë ekran dhe nuk shkruan kurrë në asnjë gazetë. Nuk e

njoh askush. E kalon jetën në fshat.

Gjatë një udhëtimi njoha dy tipa; Njëri kishte qenë spiun dhe ishte bërë pronar. Tjetri kishte qenë pronar dhe ishte bërë spiun. Sot e kësaj dite nuk e kam të qartë cili prej të dyve ishte më plehër.

Njoh një aradhe me horra që thonë se janë shkrimtarë, poetë, mendimtarë, historianë, gjeopolitikanë, por do duhej të ishin ku janë çka të tjerë, në varr.

Ndoshta nuk do ja vlen të kujtoja këta më sipër. Por tollovia e atyre që bëjnë punën e tjetrit është aq e madhe sa më duket sikur të tillë janë të gjithë.

Njoh një hajdut. Nuk vjedh kushedi se çë. Një shtëpi këtu një vilë atje. I thashë; Si nuk e kupton mor burr i dheut që je duke e çuar dem talentin. Bëhu deputet. Po u bëre, shtëpitë dhe vilat të cilave tanipërtani po u vjedh frigoriferat dhe televizorat, do ti vjedhësh nga themeli. Bëhu deputet ti që e njeh me rrënjë imatin e vjedhjes se përmirëson imazhin e parlamentit me deputetë që vjedhin por nuk dinë të fshehin.

Njoh një deputet. Po të mos i ishte futur politikës do kishte qenë kovaç ose samarxhi i hatashëm. Me çekan, kudhër, sqepar, gjylpyer, në dorë do farkëtonte sëpata, lopata, kazma, do bënte e do ndreqte samarë, dhe plot vegla të tjera të dobishme. Për tu çuditur pse e kanë këmbyer prirjen e lindur të artizanit me politikën që, siç e thonë edhe vetë në shkrimet e tyre të kërrupta, është një zanat i fëlliqur.

Janë një tufë me gazetarë që më çudisin së tepërmi. Kanë talent të lindur dhe përvoja të pasura familiare dhe fisnore për të bërë gjithfarë punësh të nderuara, për të bërë dru në mal, për të mbjellë, prashitur, korrur, për të vjelë ullinj, agrume, mandarina, portokalla. Mirpo nuk e kanë respektuar traditën, kanë ndërprerë brutalisht vazhdimësinë





# Zbulohet qelia e torturave të hetuesve komunistë ku vdiqën 50 korçarë

GLADIOLA HOXHA  
TIRANE

Nëntë vite torturash deri në vdekje, nga viti 1945 deri në '54-ën. Në këto vuajtje çnjerëzore të komunizmit kanë kaluar dhjetëra familje aristokratësh korçarë, të cilët janë torturuar me metoda nga më të dhimbshmet në një qeli hetuesie, gjurmët e së cilës janë zbuluar fare rastësisht gjatë restaurimit të ndërtesës që mbante fshehur për vite me radhë kalvarin e vuajtjeve të një populli që u shfaq kundër regjimit. Godina që dikur njihej si Komiteti i Partisë, ndodhur në qendër të qytetit, përballë Katedrales, sot i përket familjes Koçibelli. Punimet për restaurimin e saj, nxorën në pah se bodrumet kanë shërbyer gjatë kohës së diktaturës si qeli torturash dhe hetuesie.

Në muret e ngushta kanë mbetur të paprekura dëshmi të torturave ndaj të dënuarve: mbishkrime, data, emra apo thënie të të dënuarve politikë: "Kush gabon pëson, kush shpreson nuk gabon", është një thënie e shkruar në mur.

Ylber Merdani, është një dëshmi e gjallë e këtyre torturave. Në një intervistë ekskluzive për Report Tv, ai thotë se në këto biruca kanë humbur jetën nga torturat 50 persona. Kryetari i Shoqatës së të Burgosurve anti-komunistë, thotë se në katin e sipërm ishin zyrat e partisë, ndërsa poshtë tyre ishin birucat e hetuesisë, në të cilat është torturuar duke i paralizuar gishtërinjtë e duarve, edhe babai i tij Fuat Merdani.

"Fillimisht erdhën nga mali që pushtuan Korçën dhe qenë e parë që bënë krijuan këto qendra hetuesie dhe burgje. Shtëpia e Rrokos e njohin korçarët, sipër u bënë zyra kurse poshtë biruca të hetuesisë, njësoj siç kishte tek

*Dëshmia rrëqethëse e Ylber Mejdanit: Në bodrumet e ish Komitetit të Partisë, 4 qeli 1 metër katror, ku torturoheshin kundërshtarët e rregjimit, nga 1945 në '54-n. Dëshmitë e paprekura të torturave në mure*



Ylber Mejdani duke dëshmuar për Report Tv

ish-bashkia në Korçë, ose në shumë vende të tjera ku njerëzit torturoheshin me tortura që janë kalonin edhe mesjetarëve. Këtu janë torturuar shumë njerëz të ndershëm korçarë, i vetmi faj i tyre ishte që nuk u pajtuan me komunistët. Ata nuk e shpreheshin, por ishin njerëz, filantropë, bënë mirësi dhe kishin influencë tek populli, kjo nuk i pëlqente komunistëve", tregon 80-vjeçari.

Më çnjerëzisht është trajtuar vjehri i tij në këto biruca.

"Vjehrin tim e akuzonin sikur ishte pjesëtar i grupit të deputetëve,

në 47-ën, ai njeri që shikonte punën e tij kishte fituar para në Amerikë në hekurudhat që bëheshin në atë kohë, erdhi investoi këtu me mendime perëndimore, e dënuan, e sollën në këtë godinë. E futën në një si punë oazi, si punë pishine, e lidhnin në karrige, e ulnin aty, karrige e betonuar poshtë, dhe me ujë deri në grykë, dhe nuk e linin as të ulej as të ngrihej, në temperatura të ulëta. Dhe me roje e linin që mos të manovronte", thotë Merdani.

Ai tregon tmerret që kanë kaluar qytetarë të ndryshëm korçarë.

"Xhuvin e Kajnos e torturonin sa

i digjnin edhe këmbët me prush, derisa ju gangrenizuan dhe e mori zoti. E përhapën lajmin që gjeti një copë xham dhe preu damarët. Por kur doli babai nga burgu më tregoi të vërtetën.

Këto ganxha i varnin, i vinin kokë poshtë, poshtë i ndiznin kashtë, që të bukoseshin nga tymi.

I hapnin plagë me thika dhe ja mbushnin me kripë, kënaqeshin kur i shkaktonin dhimbje. Kishte të shkulura thonjsh, të varur me kokë poshtë dhe të rrinin ditë natë".

"Kanë humbur jetën nga torturat, nuk mund ta quajmë burg këtë", thotë

Merdani, teksa kujton se babai i tij dhe qytetarë të tjerë që i kanë kaluar këto vuajtje çnjerëzore, as nuk kthejnë dot kokën ndaj kësaj godinë famëkeqe. "Korçarët kur shkolin këtu brezi i baballarëve tanë, këtu lemeriseshin, nuk e kthenin dot kokën", thotë ai.

Merdani na tregon se të torturuar në këto qeli kanë qenë edhe grekët, apo shqiptarë të kthyer nga Greqia, si Koço Kota.

Me duart që i dridhen nga mosha, por edhe kujtimet e rënda që ai sjell në mend, Ylber Merdani përpiqet të kujtojë dhe emra të hetuesve të atëherëshëm. "Turinjtë njësoj i kanë pasur të gjithë, s'ka rëndësi emri, por do thoj Rafail Kërrri dhe Petrone Delli".

I lënduar, por jo me urrejtje në shpirt, Ylber Merdani thotë se rinia nuk do t'i kthehet më kurrë, por ndëshkimi për ata që vranë të pafajshëm, do të vijë vetëm përmes drejtësisë hyjnore.

"Po a më kthehet dot mua rinia? Vetëm unë kam bërë 24 vjet burgim dhe internim. Unë jam njeri i shpirtit, që bëj siç më thotë zemra, urrejtjen nuk e njoh, hakmarrjen ja kam lënë zotit që e kënaqësi që vë drejtësi në vend, të jeni të sigurt, ai do të hakmerret për të gjitha vuajtjet tona".

Pronari i godinës, Aurel Koçibelli, tregon se edhe pa restaurimit që do i bëhet godinës, pjesa që tregon historinë do të ruhet e paprekur. Kjo ndërtesë fillimisht ka qenë pronë e familjes Qirjako. Pas çlirimit të vendit nga regjimi i asaj kohe, katet e poshtme të saj i ktheu në birucë hetuesie, ndërsa lart qëndronin zyrat shtetërore. Brenda ndërtesës ende qëndrojnë 4 qeli jo me tepër se 1 metër katror.

Gjatë periudhës së diktaturës në Korçë, janë dënuar për motive 900 persona, 120 prej të cilëve janë pushkatuar, mes të cilëve edhe gra, dhe qindra familje janë internuar.



Muret e brendshme të qelisë së ish Komitetit të Partisë në Korçë

